



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



# Fëmijët si Eksplorues


Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme  
në Kosovë për fëmijët 0-6 vjeç



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

# Fëmijët si Eksplorues

Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme  
në Kosovë për fëmijët 0-6 vjeç



Ky publikim është zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit në Kosovë, Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Divizioni i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, me mbështetjen e UNICEF-it në Kosovë.

**Redaktor gjuhësor:** Global Consulting and Development Associated (GCDA)

**Fotografite:** UNICEF

**Dizajn:** Gojart Sejdiu

**Shtypshkronja:** Grafolan

Prill, 2025



## Fjala e Ministres

**Të dashur fëmijë, profesionistë të edukimit, udhëheqës, prindër\kujdestarë ligjorë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,**

Në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të Republikës së Kosovës, me krenari të madhe dhe ndjenjë të thellë përgjegjësie, përmes vendimit të aprovuar paraqes për zbatim Kurrikulën për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) për fëmijët e moshës 0–6 vjeç. Kurrikula shoqërohet nga pjesa zbatuese, që përbëhet nga udhëzuesit praktikë, të cilët e mundësojnë dhe e bëjnë më të lehtë zbatimin e saj në praktikë. Ky dokument na vendos në nismë të një udhëtimi kombëtar—atë që nis në vitet më të hershme të jetës së një fëmije dhe shtrihet drejt së ardhmes së Republikës sonë.

Kjo Kurrikulë është rezultat i punës së përkushtuar të MASHTI-t, ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë të edukimit dhe pritet të kontribuojë në përparimin e cilësisë në edukim dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të edukimit në përputhje me zhvillimet dhe kërkesat e kohës. Investimi në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, ndihmon në zvogëlimin e pabarazive në shkathtësitë themelore-veçanërisht për fëmijët në situata të cenueshme, duke zvogëluar hendekun e aftësive të tyre në të ardhmen dhe duke kontribuar në formimin e një rinie të aftë për tregun e punës, duke pasur parasysh se ky dokument stimulon zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve. Është themeli mbi të cilin ndërtojmë të ardhmen e vendit tonë: një shoqëri e mbështetur në dituri, gjithëpërfshirje dhe mundësi për çdo fëmijë. Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme është investimi ynë në qytetarët më të vegjël, në kapitalin njerëzor të Kosovës që shtyn përpara zhvillimin ekonomik, forcon kohezionin shoqëror dhe thellon vlerat tona demokratike.

Pikërisht në vitet e para të jetës, fëmijët fillojnë të vendosin themelet e zhvillimit njohës, emocional dhe social, që do t'i udhëheqin në rrugën e të nxënit gjatë gjithë jetës. E mbështetur në një qasje gjithëpërfshirëse dhe holistike, si dhe bazuar në të nxënit përmes lojës,

Kurrikula zhvillon tek fëmijët:

- Kompetencën për kreativitet dhe të menduar kritik;
- Kompetencën për komunikimin përmes gjuhëve verbale dhe joverbale;
- Kompetencën socio-emocionale;
- Kompetencën për shkencë, teknologji dhe logjikë;
- Kompetencën për qytetari globale.

Kurrikula e re për EFH-në, vendos në qendër përbërësit thelbësorë të pedagogjisë cilësore, të orientuar drejt fëmijës, siç janë:

- i) organizimi i hapësirave gjithëpërfshirëse dhe nxitëse të të nxënit, strukturimi i ditës për të nxitur edukimin gjithëpërfshirës;
- ii) forcimi i autonomisë dhe eksplorimit të fëmijës si mjet për të nxënë, zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativitetit;
- iii) inkurajimi i përfshirjes aktive të prindërve dhe kujdestarëve ligjorë në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe në shtëpi; dhe
- iv) vëzhgimi dhe dokumentimi i vazhdueshëm i punës dhe arritjeve të fëmijëve për të mundësuar vlerësim holistik të përqendruar në zhvillim.

Me zbatim të duhur të kësaj Kurrikule, synojmë të rrisim fëmijë të shëndetshëm, kuriozë, të aftë, komunikues efektiv, social dhe qytetar aktiv.

Përtej politikave, është thelbësore të vlerësojmë kontributin njerëzor që i jep jetë edukimit. Bëhet fjalë për profesionistët e përkushtuar të edukimit të hershëm, shëndetit dhe mirëqenies, prindërit dhe kujdestarët, administratorët dhe mbi të gjitha, fëmijët – potenciali i pakufishëm i të cilëve na obligon të punojmë më shumë dhe me cilësi.

Ky version i Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme reflekton përvojat nga institucionet e EFH-së në fazën pilotuese, praktikën e mira, sukseset dhe sfidat gjatë zbatimit praktik, rezultatet nga procesi i mentorimit, monitorimit dhe rekomandimet nga ekspertë, inspektorë dhe partnerë zhvillimorë kombëtarë e ndërkombëtarë. Për më tepër, Kurrikula bazohet në dëshmi shkencore dhe praktika të njohura ndërkombëtarisht në fushën e EFH-së.

Profesionistët dhe administratorët e edukimit të hershëm inkurajohen të vënë në përdorim përvojën dhe ekspertizën e tyre për zbatimin e këtij dokumenti, në bashkëpunim të vazhdueshëm me prindërit, kujdestarët ligjorë dhe komunitetin e gjerë. Ju sigurojmë se do të ofrojmë mbështetje të vazhdueshme për zbatimin e suksesshëm të kësaj Kurrikule dhe dokumenteve të tjera shoqëruese (siç janë udhëzuesit praktikë).

Së bashku, po ndërtojmë jo vetëm një sistem cilësor të edukimit të hershëm, por edhe një të ardhme të ndritur për çdo fëmijë!

Sinqerisht,  
**Arbërie Nagavci**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/  
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / Vlada / GOVERNMENT MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE, TEHNOLOGJIE I INOVACIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION		
No. Nr. No.	01-1562 DALJE	Data/Datum/Date	17.04.2025
No. Hajt. H. Sr. No.:	1		
Prishtine / Pristina / Pristina			

Numër: 01-030

Data: 17.04.2025

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 7 të Ligjit Nr. 08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (G.Z. e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 3 Gusht 2023, Prishtinë), nenparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/Nr. 34/18 Nëntor 2022, Prishtinë), nxjerrë:

**V E N D I M**  
**Për aprovim**

1. Aprovohet Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, në Kërkesën me nr.prot. 01 - 029 dt.16.04.2025, si dhe me qëllim të aprovimit të Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

1. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
2. Zyrës së Sekretares së Përgjithshëm/MASHTI;
3. DAP/MASHTI;
4. Arkivit /MASHTI.





# Shkurtesat

<b>EFH</b>	Edukimi në fëmijërinë e hershme
<b>IEFH</b>	Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme
<b>ISO</b>	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
<b>KSNA</b>	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>KOMF</b>	Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>UNICEF</b>	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
<b>UNESCO</b>	Organizata për Edukim, Shkencë, Kulturë e Kombeve të Bashkuara
<b>ZHFH</b>	Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme



# Pëmbajtja

Fjala e Ministres	3
Shkurtesat	7
<b>Kapitulli I</b>	
<b>1. Hyrje</b>	<b>13</b>
1.1 Struktura e kurrikulës	13
1.2 Teoritë e të nxënit	14
1.3 Ideja e fëmijërisë	14
<b>Kapitulli II</b>	
<b>2. Synimi, parimet, dhe konteksti</b>	<b>19</b>
2.1 Synimi i Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme	19
2.2 Vlerat dhe Parimet	20
2.3 Ndjeshmëria kontekstuale e kurrikulës	22
<b>Kapitulli III</b>	
<b>3. Kompetencat kurrikulare</b>	<b>25</b>
3.1 Kompetenca për kreativitet dhe të menduar kritik	25
3.2 Kompetenca për komunikim përmes gjuhëve verbale dhe joverbale	29
3.3 Kompetenca socio-emocionale	33
3.4 Kompetenca për shkencë, teknologji, dhe logjikë	36
3.5 Kompetenca për qytetari globale	38
<b>Kapitulli IV</b>	
<b>4. Qasja pedagogjike dhe elementet në zbatim të kurrikulës</b>	<b>43</b>
4.1 Mjedisi i të nxënit	43
4.2 Materialet	44
4.3 Roli i edukatorit/es	45
4.4 Mjetet e planifikimit	46
4.5 Organizimi i kohës	47
4.6 Dialogu edukator/e-fëmijë	50
4.7 Gjithëpërfshirja dhe qasja gjithëpërfshirëse	50
4.8 Pjesëmarrja e familjes	52
4.9 Tranzicionet	55
<b>Kapitulli V</b>	
<b>5. Dokumentimi dhe vlerësimi në procesin e të nxënit</b>	<b>59</b>
5.1 Vlerësimi dhe të nxënit	59
5.2 Vëzhgimi	60
5.3 Dokumentacioni pedagogjik	60
5.4 Dokumentimi i vlerësimit (shpeshësia dhe forma)	61
<b>Kapitulli VI</b>	
<b>6. Fjalorthi i kurrikulës</b>	<b>65</b>
Burimet	70



# Kapitulli I

Hyrje

1



# 1. Hyrje

## 1.1 Struktura e kurrikulës

**K**urrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH), është dokumenti themelor mbi bazën e të cilit organizohet veprimtaria edukative në institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme. Roli i dokumentit të Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme është të ndihmojë zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës duke ndjekur dhe përshtatur me traditën edukative vendore dhe me trendet zhvillimore në vend dhe në nivel ndërkombëtar. Kurrikula poashtu mbështetë dhe orienton punën në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme në të gjitha format e organizimit. Për këtë arsye, dokumenti është një përmbledhje teorish, parimesh, vlerash, kompetencash dhe qasjesh pedagogjike, vështrimi sistematik i të cilave ka kuptim vetëm nëse shihet në vazhden e të gjithë pakos së dokumenteve përcjellëse që e përbëjnë dhe e bëjnë të zbatueshme këtë kurrikulë për Edukimin në fëmijërinë e hershme.

Pakoja kurrikulare përbëhet nga një tërësi dokumentesh, të cilat ndahen në dy pjesë kryesore:

**Pjesa konceptuale** - që është vetë Kurrikula, dhe

**Pjesazbatuese** - që përbëhet nga dokumentet shoqëruese (udhëzuesit praktikë), të cilët e mundësojnë dhe e bëjnë më të lehtë zbatimin e saj në praktikë.

Si qytetar global në një botë në ndryshim dhe gjithnjë e më të ndërlidhur, fëmija duhet të jetë i adaptueshëm, hulumtues, krijues dhe fleksibil. Ai/ajo duhet të zhvillohet dhe të mësojë se si të mësojë në mënyrë që të adaptohet me situata dhe kontekste të reja. Për këto arsye, kurrikula ka në fokus zhvillimin dhe edukimin e fëmijës, zhvillimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, prirjeve që mbështesin të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Të gjithë fëmijët lindin me kapacitete të ndryshme; prandaj, edukimi cilësor në moshën e hershme i ndihmon ata të zhvillojnë këto kapacitete dhe të ndërtojnë një bazë të fortë për jetën e përditshme dhe të mësuarit në të ardhmen. Kurrikula për edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë bazohet në themelet pedagogjike, kulturore dhe organizative mbi teoritë më të fundit të të nxënimit dhe qasjet më bashkëkohore dhe novatore të kurrikulës.

Kurrikula e EFH-së është një kurrikulë e hapur, e frymëzuar nga udhëzuesi i IBE-UNESCO-s mbi kompetencat e shekullit të 21-të ([IBE-UNESCO, 2017](#)). Ajo përfshin elementë thelbësorë të kulturës vendore dhe kulturave bashkëkohore, si përqendrimin në zhvillimin e kompetencave, vëmendjen ndaj edukimit për qytetarinë globale, ndjeshmërinë ndaj çështjeve gjinore dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekonomike.

Prandaj, korniza e UNESCO-s shërben si referencë për përcaktimin e kompetencave të kësaj kurrikule, të cilat janë të grupuara në pesë kategori dhe mbulojnë kompetencat që një fëmijë duhet të zhvillojë gjatë fëmijërisë së hershme (deri në moshën 6 vjeç kur fillon arsimit fillor).

Procesi i të nxënimit duhet të shihet si diçka përtej aftësive të përgjithshme që zhvillohen dhe dokumentohen. Kështu, kjo kurrikulë i qaset të nxënimit në mënyrë holistike, duke e konsideruar si një proces të vazhdueshëm dhe kompleks, duke marrë mbështetje dhe frymëzim nga përvojat edukative të qasjeve dhe metodologjive të ndryshme që kanë shërbyer si referencë për shumë vite me radhë, si **Reggio Emilia, Montessori, Step by Step** dhe Maieutika Sokratike (ndër të tjera). Përveç kësaj, kjo kurrikulë merr parasysh traditat, vlerat kulturore, si dhe karakteristikat kontekstuale dhe kombëtare të vendit.

## 1.2 Teoritë e të nxënit

Kur flasim për fëmijën mbështetemi në kërkimet shkencore të dala nga fushat si biologjia, filozofia, psikologjia, arkitektura dhe neuroshkenca. Është thelbësore që vazhdimisht të merret parasysh konteksti i kërkimit shkencor, i cili duhet të integrohet në kërkimet që bëhen çdo ditë në institucionet e edukimit dhe në praktikën që përvoja na shtyn t'i zhvillojmë.

Fëmija, që nga lindja, është i/e motivuar për ta krijuar kuptimin (Moss, Dahlberg dhe Pence, 1999) për botën dhe proceset në të. Është një përpjekje, një kërkim që fillon dhe zhvillohet në mënyrë të pavarur, në përputhje dhe orientim të fortë me mjedisin dhe kontekstin social në të cilin ndodhin ngjarjet. Konteksti është thelbësor për zhvillimin e fëmijës dhe si i tillë mundëson kërkime të vazhdueshme.

Fëmija zhvillon në mënyrë të pavarur aftësitë e të nxënit, strategjitë, mënyrat dhe shtigjet sesi t'i integroj dhe lidhë ato me praktikën. Kështu, ata prodhojnë instrumente dhe teori kognitive (njohëse) rreth konteksteve që i rrethojnë. Fëmija krijon "hartat mendore" që i mundësojnë atij\asaj ta orientojë kërkimin. Këto harta mendore e orientojnë fëmijën për nga pikëpamja sociale, njohëse, simbolike, afektive, relacionale dhe emocionale.

Fëmija bëhet protagonist aktiv, kritik, i fortë dhe kompetent i zhvillimit dhe edukimit të tij\asaj. Ai\ajo prodhon ndryshime, krijon dhe krahason mendime, prodhon njohuri dhe kulturë, dhe zhvillon aftësi të pakufizuara komunikimi, që rrjedhin nga mundësia e zotërimit të shkathtësive dhe stileve të ndryshme të të nxënit. Fëmijët mund të ndërtojnë gjuhë, simbole dhe kode, t'i interpretojnë ato ekzistuese dhe t'i përcaktojnë kuptime, madje edhe mjaft komplekse, ngjarjeve rreth tyre.

Hulumtimet e fundit mbi proceset e të nxënit kanë rrëzuar poshtë teoritë tradicionale të të nxënit linear. Tashmë është dëshmuar dhe ekziston një ndërgjegjësim i përgjithshëm se përvetësimi dhe zhvillimi i njohurive të reja është një proces, në të cilin individi/fëmija që mëson, ka rol aktiv në ripërpunimin dhe riorganizimin e informacioneve. Mbi të gjitha, procesi i të nxënit bazohet në mënyrën sesi

organizohet njohja/njohuria. Ai është filtër nëpër të cilin kalojnë informacionet e reja dhe kriter që përdoret për pranimin ose refuzimin e tyre.

Ne nuk mund ta mendojmë më procesin e mësimdhënies/nxënies si një kalim nga një fushë në tjetrën, siç është bërë në praktikën e mëhershme, por tani përmbajtja edukative në praktikë ofrohet duke i nderlidhur fushat apo kompetencat.

Një referencë thelbësore teorike në nivelin kurrikular është Jerome Brunner, një nga interpretuesit më inovatorë dhe bashkëkohorë të kurrikulës së hapur dhe në zhvillim, e njohur edhe si kurrikula spirale.

Teoritë që çuan në këtë konceptim të ri të dijes përshkruhen më hollësisht në dokumentin e ndarë (udhëzuesin mbi teoritë e të nxënit), pjesë e paketës kurrikulare, në të cilin janë ofruar gjerësisht disa koncepte për të udhëzuar të menduarit mbi të nxënit e fëmijëve, siç janë:

- Teoria konstruktiviste
- Teoria ndërvepruese
- Teoria social-konstruktiviste dhe
- Teoria sistemike

## 1.3 Ideja e fëmijërisë

Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, së bashku me dokumentet e tjera mbështetëse, bazohet në Kornizën e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar, e miratuar nga MASHTI në gusht të vitit 2016. Kjo kurrikulë në strukturë dhe në përmbajtje, dallon nga kurrikulat bërthamë për nivelet e tjera formale të arsimit dhe i përshtatet moshës dhe specifikave të fëmijërisë së hershme. Sikurse kurrikulat bërthamë për nivelet e tjera të arsimit parauniversitar, edhe kjo kurrikulë organizohet në kompetencat e të nxënit, të cilat ndërlidhen dhe i kontribuojnë arritjes së kompetencave të arsimit parauniversitar.

Klasa parafillore (mosha 5-6 vjeç), kalon nga kurrikula bërthamë për KSNA 1 dhe bëhet pjesë e kësaj kurrikule, e cila në aspektin përmbajtësor zbatohet njëjtë për të gjitha format e organizimit të edukimit në fëmijërinë e hershme.

Nivelet sipas KSNA [1]		Nivelet Formale të Arsimit Parauniversitar në Kosovë [2]	Mosha
		Arsimimi i të rriturve/Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)	23/24+
KSNA 6		Arsimi pasuniversitar	23/24+
KSNA 5		Arsimi universitar	
KSNA 4	Niveli 5 Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi passekondar jouniversitar	18 +
KSNA 3	Niveli 4 Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Gjimnazi klasa X-XII Shkollat profesionale (klasat X-XII)	Matura 15-17
	Niveli 3 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Shkollat profesionale (klasat X-XI)	15-16 Shkollat profesionale
KSNA 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX	11-14
KSNA 1		Arsimi fillor Klasat I-V	6-10
KSNA 0	Klasa përgatitore		5-6
	Edukimi parashkollor		lindje-5

Institucionet që ofrojnë edukim në fëmijërinë e hershme janë mjedise edukative që përmbajnë situata dhe marrëdhënie në mes të fëmijëve dhe të rriturve dhe prej ku buron të nxënit dhe ndërtimi kulturor. Me këtë bindje, ky dokument synon të kontribuojë në ndërtimin e një imazhi gjithëpërfshirës dhe të avancuar të fëmijërisë. Edukimi në fëmijërinë e hershme mishëron një qasje të orientuar drejt eksplorimit dhe lojës në kontekstin e edukimit të hershëm në të gjithë Kosovën, por edhe me ndërlidhje rajonale dhe ndërkombëtare.

Është thelbësore të reflektojmë mbi idenë që kemi për fëmijën. Në këtë mënyrë, i japim kuptim fjalës “fëmijëri”.

Reflektimi mbi idenë e fëmijërisë do të thotë të diskutojmë interpretimet dhe përcaktimet historike dhe kulturore të njerëzimit. Fëmijët përcaktohen përmes perspektivës sonë, mënyrës se si i shohim ata dhe, rrjedhimisht, përmes filtrit tonë kulturor. Prandaj, ideja për

fëmijën është ajo që dimë dhe supozojmë për të, si dhe imazhi i fëmijës bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).

Proceset njohëse, simbolike, afektive, sociale dhe marrëdhëniet e krijuara ndërlidhen me kontekstin e institucioneve për fëmijërinë e hershme ku fëmijët zhvillohen. Prandaj, formimi i fëmijës është proces social, sepse krijimi i njohurive dhe aftësive të tij/saj ndërtohet në marrëdhënie të ngushta me të tjerët, si me fëmijët e tjerë ashtu edhe me të rriturit.

Fëmija ka të drejtën e respektit në komunikim, është mbajtës i të drejtave që nga lindja, dhe është njëkohësisht ndërtues i njohurive, dijes dhe kulturës. Duke qenë kështu, fëmijët pasurojnë dhe prezantojnë kulturën e familjes dhe të vendit të tyre. Fëmija mëson dhe rritet në marrëdhënie me të tjerët duke marrë pjesë aktivisht në botën që e rrethon, duke përfshirë në aktivitete, ngjarje të ndryshme

në komunitet që në moshë të hershme.

Kurrikula përcakton në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëllimshme praktikën edukative bazuar në një perspektivë holistike. Ajo udhëzon aktivitetet e edukatorëve dhe të gjithë profesionistëve të përfshirë në edukimin në fëmijërinë e hershme. Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme përcakton përmbajtjen themelore të edukimit për fëmijët e moshës 0-6 vjeç në vendin tonë, ndërsa shkencërisht, perioda e fëmijërisë mund të shtrihet deri në moshën 8 vjeç.

Një kurrikulë holistike, e qëllimshme dhe gjithëpërfshirëse sjell përfitime të shumta për zhvillimin e sistemit edukativ dhe arsimor, ndërsa në punën edukative të institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (ECE) kontribuon në:

- Organizimin e përgjithshëm të punës edukative
- Vlerësimin përmes vëzhgimit dhe dokumentimit
- Projektet zhvillimore dhe edukative
- Përfshirjen e familjes dhe komunitetit
- Zhvillimin profesional të stafit edukativ dhe mbështetës
- Mjediset edukative (hapësirat dhe materialet).

Zbatimi i kurrikulës duhet të vendosë gjithmonë misionin e fëmijës në qendër të çdo veprimi, duke mbështetur stafin e EFH-së dhe institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme në proceset e zhvillimit dhe të nxënies të fëmijës, si dhe duke ofruar përvoja të pasura për zhvillimin e tyre holistik.



# Kapitulli II

Synimi, parimet,  
dhe konteksti







## 2. Synimi, parimet, dhe konteksti

### 2.1 Synimi i Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme

**S**ynimi i Kurrikulës për EFH-në, është të mbështetë mirëqenien, të nxënit përmes lojës shprehitë e jetës së shëndetshme dhe zhvillimin e fëmijës si eksplorues. Është thelbësore të reflektojmë mbi idenë dhe të kuptuarit që kemi për fëmijën dhe fëmijërinë në përgjithësi, në mënyrë që t'i japin kuptimin e duhur fjalës fëmijëri. Kjo kurrikulë, synon të pasqyrojë aftësitë dhe shkathtësitë që

mbështesin zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës si individ i pavarur, mendimtar kritik dhe i hapur, dhe me vetëbesim drejt së ardhmes.

Po ashtu ka për synim të gjenerojë përvoja edukative në interesin më të mirë të fëmijës në institucionet e edukimit në fëmijërine e hershme por edhe në mjedisin familjar në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët ligjorë.

Institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme janë mjedise edukative që nxisin dhe mbështesin fëmijët përmes krijimit të situatave në mbështetje të marrëdhënieve reciproke në jetën e përditshme.



## 2.2 Vlerat dhe Parimet

Historia, traditat dhe kultura në kontekstin Kosovar, dhe trendet bashkëkohore, diktojnë vlerat që paraqesin themelin për ndërtimin e kurrikulës për EFH-në. Këto janë:

**Ndërkulturalizmi:** Kosova është një vend ndërkulturor, historikisht i karakterizuar nga një unitet etniko-kulturor midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike. Parë nga ky këndvështrim, bashkëjetesa në shoqërinë kosovare del në pah si një vlerë dhe “model” për shoqëritë e tjera në kontekstin globalist ku multikulturalizmi përbën sfidën kryesore të shoqërive moderne. Është parimi i ndërkulturalizmit, i bashkëjetesës paqësore dhe i integritetit të të gjitha komuniteteve që edukohen brenda sistemit edukativo-arsimor kosovar që mundësojnë që institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme të mirëpresin çdo fëmijë. Elementet ndër-kulturore duhet të jenë të pranishme në kompetencat e ndryshme dhe të aplikohen në çdo qasje pedagogjike të zgjedhur për të zhvilluar procesin edukativ në institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme.

### **Familja në funksion të rritjes, edukimit, dhe mbështetjes së vazhdueshme:**

Tradicionalisht, shoqëria kosovare i ka njohur katër funksione bazike të familjes: funksioni i rritjes dhe edukimit të fëmijëve, funksioni i riprodhimit, funksioni i mbështetjes ekonomike dhe, funksioni mbrojtës dhe shoqërues i familjes. Këto funksione kanë pësuar ndryshime të herëpashershme, megjithatë familja nënkupton bashkësinë themelore të shoqërisë, të bazuar në afërsi, dashuri, harmoni dhe respekt. Çdo fëmijë duhet të respektohet dhe të mësojë një kulturë respekti reciprok ndaj bashkëmoshatarëve, të rriturve dhe mjedisit që e rrethon. Kjo vlerë pasqyrohet në qasjen e kurrikulës për EFH, e cila thekson poashtu rolin e pandashëm të familjes me institucionin e EFH-së.

Në kulturën kosovare poashtu vlerësohet lartë **kujdesi ndaj personave në nevojë**, duke përfshirë të moshuarit, grupet e cenueshme si edhe fëmijët, të cilët gëzojnë konsideratë të lartë si në familje, ashtu edhe në bashkësi\ komunitet.

**Popullsia e re:** Kosova është shteti i vetëm në Evropë që klasifikohet të jetë në periudhën

e dividendës së hershme të popullsisë. Kjo nënkupton se përqindja e popullsisë së moshës aktive në punë dhe në riprodhim është më e lartë se sa përqindja e popullsisë së varur apo joaktive në punë. Kjo paraqet një mundësi të artë për investime të vazhdueshme në kapitalin njerëzor përmes edukimit, politikave në mbështetje të familjes dhe progresit të përgjithshëm në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie.

Që këto vlera të frymojnë, kurrikula thekson parimet themelore, të cilat bazohen edhe në legjislacionin kosovar dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), si:

**Gjithëpërfshirja:** Ky parim në fëmijërinë e hershme nënkupton krijimin e një mjedisi që mirëpret dhe mbështet të gjithë fëmijët, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, origjina kombëtare, etnike apo sociale, gjendja ekonomike, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare ose çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve / kujdestarëve të tij/saj ligjorë. Institucionet e EFH- së, duhet të sigurojnë kujdes dhe edukim për të gjithë fëmijët me një qasje të bazuar në pjesëmarrje; mbështesin angazhimin e edukatorëve, stafit mbështetës profesional, drejtuesve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit të institucionit. Këto janë thelbësore për të siguruar përfshirjen dhe edukimin në grup për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga dallimet.

Ashtu si qëllimet e edukimit gjithëpërfshirës, qëllimet kryesore të kurrikulës sa i përket gjithëpërfshirjes, janë të sigurojnë që çdo fëmijë të përjetojë një ndjenjë përkatësie brenda komunitetit edukativ dhe të forcojë ndjenjën e identitetit të secilit fëmijë si individ. Materialet edukative, hapësira e të nxënit dhe qëndrimet e edukatorit\es luajnë rol kryesor në promovimin e diversitetit (llojllojshmërisë), barazisë dhe përfshirjes në hapësirat e edukimit të fëmijërisë së hershme.

Këto aspekte duhet të funksionojnë së bashku për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës, në të cilin dallimet njerëzore njihen dhe vlerësohen. Materialet edukative në klasë\grup, duhet të përfaqësojnë diversitetet. Lodrat dhe materialet duhet të përfaqësojnë diversitetin gjinor. Ushqimet, festat dhe festimet duhet të pasqyrojnë grupet e ndryshme të pranishme në klasë\grup.

**Fëmija në qendër** - Një qasje më fëmijën në qendër është e bazuar në teorinë e fëmijërisë së hershme dhe thekson ndërtimin individual të dijes bazuar në interesat, nevojat zhvillimore dhe aftësitë e fëmijëve. Po ashtu, ajo u ofron fëmijëve mundësinë të eksperimentojnë, të dallojnë, të mendojnë në mënyrë kritike, dhe të jenë krijuar ndërsa përfitojnë njohuri dhe dije. Vënia e fëmijës në qendër të procesit pedagogjik çon në një strukturim të ndryshëm të të nxënit, mjedisit edukativ dhe rolit që të rriturit (stafi edukativ prinderit\ kujdestarët ligjorë) marrin në motivimin e fëmijës për të nxënë, për të zhvilluar dhe për të përdorur aftësi të ndryshme.

Kjo qasje pedagogjike, kërkon që stafi edukativ të krijojë mjedise të ndryshme të qëllimshme që përfaqësojnë kontekste nga jeta e përditshme me qëllim që fëmijët të fitojnë përvoja të dobishme dhe të zhvillojnë shkathtësitë e parapara në këtë kurrikulë.

Të gjithë edukatorët ndërveprojnë me fëmijë me përkatësi, aftësi, interesa dhe nevoja edukative të ndryshme në institucionet e EFH-së. Në mjedise gjithëpërfshirëse të edukimit të hershëm, stafi edukativ përdor pedagogji të orientuar nga fëmija për të vëzhguar dhe plotësuar nevojat dhe interesat e të gjithë fëmijëve. Në shumë pjesë të botës, edukimi është shumë tradicional (mësim me memorizim) dhe në shumë kultura, respekti për mësuesin/edukatoren është shumë i rëndësishëm. Kur zbatohet një pedagogji e orientuar nga fëmija, kushtet lokale dhe kultura duhet të respektohen dhe të merren parasysh. Është e mundur të implementohen elemente të pedagogjisë së orientuar nga fëmija në një sistem më tradicional. Pika kyçe që duhet të kujtojmë është se për të zhvilluar një pedagogji me fëmijën në qendër, stafi edukativ shpesh duhet të fillojë të ndryshojë sjelljen e tyre në grup: ku qëndrojnë, si përdorin burimet, mënyrën se si flasin dhe ndërveprojnë me fëmijët dhe mënyrën se si vlerësojnë arritjet e fëmijëve.

**Të nxënit përmes lojës:** Një qasje e edukimit të hershëm të bazuar në lojë mbështet zhvillimin e fëmijëve bazuar në nevojat e tyre, promovon zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit dhe ofron mundësinë për stafin edukativ që të përkthejnë kurrikulën në aktivitete të

lojës. Teoritë e EFH-së theksojnë se gjuha dhe të nxënit janë të lidhura ngushtë dhe se dija ndërtohet përmes një qasjeje të bazuar në lojë që ofron mundësinë për ndërveprim social me bashkëmoshatarë dhe të rritur, të shprehur përmes gjuhës. Për të jetësuar të nxënit përmes lojës, stafi edukativ përdor pedagogji të përgjegjshme ndaj kulturës (duke mbështetur gjuhën, vlerat kulturore dhe zakonet) që lidh përvojat e shtëpisë dhe të klasës, është i vetëdijshëm për fazën zhvillimore të fëmijëve, dhe sheh fëmijët si burim dhe formësues të kurrikulës në vazhdimësi.

### 2.3 Ndjeshmëria kontekstuale e kurrikulës

Kurrikula fillon me kuptimin e kontekstit në të cilin po zhvillohet fëmija. Analizimi i kontekstit është një hap i parë i domosdoshëm në zhvillimin e kompetencave të nevojshme. Konteksti zakonisht është kompleks,

shumëdimensional dhe i larmishëm. Çdo kontekst paraqet nevoja të ndryshme të një natyre individuale dhe kolektive. Shekulli 21, veçanërisht bota digjitale, imponon sfida dhe mundësi për të cilat fëmija dhe edukatori\ja duhet të përgatiten. Kurrikula e mbështet fëmijën në zhvillimin e aftësive për t'i trajtuar këto sfida në mënyrë efektive. Ajo duhet të identifikojë dhe të krijojë mundësi, duke prodhuar kështu përfitime individuale, kolektive dhe globale.

Kurrikula kosovare, po ashtu ka si element thelbësor, elementet e veçanta të kulturës vendore. Ky aspekt garanton konsistencën me kontekstin. Prandaj, kurrikula merr në konsideratë elementet e kulturës vendore të lidhura me kujdesin dhe edukimin e fëmijës që në moshë të hershme. Është thelbësore që kurrikula të rrjedhë nga nevojat dhe mundësitë kontekstuale dhe t'i adresojë ato për të siguruar që rezultatet e të nxënit janë relevante dhe praktike dhe mbështesin zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës, si dhe e përgatisin fëmijën për jetë dhe për shkollë.

# Kapitulli III

Kompetencat  
kurrikulare





## 3. Kompetencat kurrikulare

**N**ë kurrikulën për edukimin në fëmijërinë e hershme, kompetenca përkufizohet si aftësia e zhvillimit ndërveprues për të përdorur dhe përmbledhur në mënyrë etike informacionin, njohuritë, aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe teknologjitë, për t'u angazhuar në mënyrë efektive dhe për të vepruar në mënyra të ndryshme për ta arritur të mirën individuale, kolektive dhe globale. Me këtë përkufizim kuptohet se mbështetja e fëmijës në përvetësimin e njohurive, aftësive dhe vlerave, duhet të plotësohet me ofrimin e mundësive që fëmija të krijojë lidhje nëpërmjet elementeve të kompetencave ose aftësive të shumëfishta, t'i integroj dhe zbatoj ato në mënyrë interaktive për t'iu përgjigjur situatave të ndryshme dhe për të ndikuar në ndryshim të situave sipas nevojës. Qasja me një "listë" aftësish që duhen mësuar nuk është më e zbatueshme në shumë kontekste globale. Ndërsa, përcaktimi sesi mund të zhvillohet të nxënit përgjatë procesve të shpejta dhe të paparashikueshme tani është qenësore.

Kurrikula e bazuar në kompetenca inkurajon fëmijën të njoh dhe t'i kuptojë më thellë njohuritë. Zbatimi i tyre shpesh drejtohet drejt situatave të jetës reale (të nxënit duke bërë) që fëmija mund t'i hasë më vonë në jetë, duke i ofruar atij/saj mundësinë për ta zbatuar atë që ka mësuar. Kurrikulat e bazuara në kompetenca, ndryshe nga ato tematike/disiplinore, bazohen në të kuptuarit.

Kurrikula dhe qasja e bazuar në kompetenca, ndërtohet nga fëmija dhe i rrituri në atë mënyrë që i mundëson dhe e inkurajon fëmijën të përdor atë që mësohet në situatat e përditshme. Megjithatë, zbatimi dhe vënia në veprim e kompetencave nuk është qëllimi përfundimtar i procesit të të nxënit.

Kjo kurrikulë e bazuar në kompetenca është shumëdimensionale dhe kërkon angazhim serioz, përvojë praktike dhe eksplorim të të

gjitha fushave, shpesh edhe njëkohësisht, pasi ato natyrshëm mbivendosen me njëra-tjetrën dhe punojnë së bashku në përvojat dhe skenarët e jetës reale. Kompetencat kurrikulare të cilat do të zhvillohen në edukimin në fëmijërinë e hershme, të zbërthyer në këtë kurrikulë janë:

- Kompetenca për kreativitet dhe të menduar kritik
- Kompetenca për komunikimin përmes gjuhëve verbale dhe joverbale
- Kompetenca socio-emocionale
- Kompetenca për shkencë, teknologji, dhe logjikë
- Kompetenca për qytetari globale

### 3.1 Kompetenca për kreativitet dhe të menduar kritik

**Metanjohja apo metakognicioni** i referohet aftësisë së një individi për të menduar dhe reflektuar mbi proceset e tyre të të menduarit. Kjo përfshin dy komponentë kritikë: aspektet njohëse dhe funksionimin ekzekutiv/zbatimin e njohurive. Në kontekstin e edukimit të fëmijërisë së hershme, metanjohja i referohet zhvillimit të vetëdijes dhe të kuptuarit të mendimeve të fëmijëve, njohurive dhe strategjive të të nxënit në moshën e hershme. Ajo përfshinë aftësinë për të monitoruar, zhvilluar dhe reflektuar mbi proceset e veta njohëse dhe për të vetërregulluar angazhimin gjatë proceseve edukative dhe të të nxënit. Stafit edukativ mbështet zhvillimin e metanjohjes përmes:

- mbështetjes së fëmijës në të kuptuarit e mendimeve të tij/saj ;
- nxitjen e tij/saj për të reflektuar mbi përvojat e veta të të nxënit;-
- mbështetjen në përcaktimin

e qëllimeve të të nxënit dhe planifikimin e strategjive për t'i arritur ato;

- mbështetjes së aftësive për vetëreflektim dhe vetëvlerësim për të zhvilluar aftësitë dhe shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve.

Metakognicioni në fëmijërinë e hershme ka të bëjë me kuptimin e përvojave personale të përditshme të jetës, situatave të ndryshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndërlidhjen e tyre në mjediset e të nxënit. Metakognicioni tregon aftësinë e fëmijës për të reflektuar mbi shkathtësitë e zotëruara në mënyrë që t'i përdorë ato në situatat e ndryshme jetësore në mënyrë të përshtatshme.

**Mendimi kritik** në edukimin në fëmijërinë e hershme i referohet aftësisë së fëmijës për ta analizuar informacionin, për të kuptuar perspektiva të ndryshme, në mënyrë që t'i zgjidhë problemet dhe të marrë vendime. Kjo është një aftësi komplekse për të cilën duhet të përdoren procese të të menduarit të nivelit më të lartë, si analiza, sinteza dhe vlerësimi. Qëllimi i të menduarit kritik në edukimin në fëmijërinë e hershme është ta

ndihmojë fëmijën ta kuptojë më thellë botën përreth tij\ saj dhe ta pajisë atë me mjetet që i nevojiten për t'i kuptuar dhe përdorur informacionet dhe idetë komplekse. Kjo do t'i inkurajoj ata të mësojnë të jenë individë kureshtarë gjatë gjithë jetës dhe në situata të ndryshme. Përta zhvilluar të menduarit kritik, është e nevojshme që fëmijët të ekspozohen në mjedise inkurajuese për të bërë pyetje dhe për të shprehur kureshtjen për ambientin përreth tyre. Kjo rrugë, e cila mund të përmbledhet si kureshtje e përgjithshme e fëmijës për botën, ushqen formimin e ideve, situatave për eksplorim, dhe gjenerimin e teorive.

Prandaj, si pikënisje fëmija duhet të jetë kureshtar për botën që e rrethon, të zhvillojë vazhdimisht mënyra për t'i eksploruar idetë dhe mjedisin e tij\ saj. Staf i edukativ mbështetet fëmijët për ta arritur potencialin e tyre në çdo fazë të zhvillimit dhe nxitë dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës nëpërmjet udhëzimeve të qarta, pyetjeve të strukturuar dhe zhvillimit adekuat të programit.

**Kreativiteti** është një proces gjithëpërfshirës që nuk kufizohet vetëm në art dhe nuk është diçka që vetëm "disa" njerëz mund ta bëjnë.



Kreativiteti shprehet në gjithçka që bëjmë. Është mënyra se si ne e shohim botën, si mendojmë dhe krijojmë ide, dhe se si i qasemi një problemi për ta zgjidhur atë. Për të shprehur kreativitetin e tyre, fëmijët duhet të jenë në gjendje të lexojnë dhe kuptojnë situatën në mjedisin e tyre dhe të kuptojnë mendimet e të tjerëve. Staf i edukativ duhet të diskutojnë me fëmijën dhe t'i kuptojnë proceset e tij/saj të të nxënit si dhe ta bëjnë fëmijën të shoh një situatë, çoftë ajo edhe problematike, nga këndvështrime të ndryshme. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që nxit të menduarit kritik, shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve dhe të nxënit kreativ është jetik për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës si eksplorues. Ndër aspektet thelbësore të dizajnit të një mjedisi të të nxënit kreativ është gatishmëria dhe perkushtimi i të rriturve (edukatorit/es, dhe prindit/kujdestarit ligjor) për të dëgjuar dhe pranuar reagimet, përgjigjet dhe propozimet e fëmijës, dhe për të kërkuar nga fëmija të shpjegoj dhe arsyetoj veprimet, përgjigjet, dhe reagimet e tij/saj.

Kreativiteti duhet të zhvillohet dhe mundësohet që në fëmijërinë e hershme për të ruajtur individualitetin e çdo fëmije dhe për të përfituar nga kjo veçanti si shoqëri.

**Zgjidhja e problemeve** tregon procesin kognitiv (njohës) që zbatohet për të analizuar situatën problematike dhe për të gjetur një zgjidhje. Është një proces që përfshin zbatimin e hapave të qëllimshëm lidhur me një situatë apo rrethanë të caktuar, për të arritur një rezultat të dëshiruar.

Zgjidhja e problemeve fillon së pari me reflektim dhe arsyetim për të ndërmarrë hapa të strukturuar përtë zgjidhur një situatë komplekse, e cila nuk mund të arrihet vetëm me një qasje intuitive.

Zgjidhja e problemeve te moshat 0-3 vjeç fillon kur fëmijët eksplorojnë botën përreth tyre përmes shqisave. Foshnjat shpejtë ndërtojnë aftësi të të menduarit dhe motorike që u lejojnë të prekin dhe të luajnë me objekte, të provojnë si funksionojnë gjërat dhe të gjejnë zgjidhje të thjeshta. Një foshnjë që shtrihet për të kapur një lodër afër tregon zgjidhje të hershme të problemeve duke ndryshuar lëvizjet ose duke kërkuar ndihmë. Ky të mësuar ndodhe shpesh gjatë dhe përmes lojës.

Fëmijët luajnë me lodra, provojnë gjëra të reja dhe mësojnë nga suksesi dhe dështimi. Të rriturit ndihmojnë shumë duke krijuar hapësira të përshtatshme, duke ofruar mundësi për të zgjidhur probleme dhe duke dhënë ndihmë pa u imponuar.

Të ndjerit të sigurt është thelbësore, sepse fëmijët që ndihen të sigurt rrezikojnë më shumë dhe vazhdojnë të përpriqen. Fjalët i ndihmojnë fëmijët gjithashtu. Fëmijët shumë të vegjël shprehin nevoja të ndryshme, kërkojnë gjëra dhe ndjekin udhëzime. Loja me të tjerët dhe me të rriturit u mëson atyre zgjidhjen e përbashkët të problemeve. Fëmijët mësojnë të flasin për mendimet e tyre dhe t'i ndajnë ato.



### Vëmendje për edukatorët

Edukatorët ndërtojnë një mjedis që nxit kuriozitetin, eksplorimin dhe imagjinatën. Ata/ato u japin fëmijëve materiale të hapura, si blloqe, mjete arti dhe objekte natyrore, për të frymëzuar të menduarit krijues dhe zgjidhjen e problemeve. Aktivitetet u lejojnë fëmijëve të provojnë ide të reja dhe të reflektojnë mbi rezultatet, si projekte ndërtimi, loja me role/bëj sikur apo tregime. Fëmijët duhet të bëjnë pyetje dhe të ndajnë mendimet e tyre hapur. Pyetje të thjeshta si “Çfarë mendon se do të ndodhë nëse...?” ose “Si mund ta zgjidhim këtë problem ndryshe?” ndihmojnë këtë proces. Vlerësoni përpjekjet e tyre duke çmuar idetë e tyre dhe duke vlerësuar kreativitetin, edhe nëse rezultatet nuk janë perfekte. Edukatorët udhëheqin projekte në grup që fëmijët të bashkëpunojnë, të mësojnë nga perspektiva të ndryshme dhe të zhvillojnë ide të përbashkëta. Projektet në grup janë shumë të rëndësishme.



## Qëllimet për të nxënit për Kompetencën 1: Kreativiteti dhe Mendimi Kritik

### Grup-mosha 0-2 vjeç

- Fëmijët eksplorojnë mjedisin e tyre duke përdorur shqisat si prekjen, shikimin, dëgjimin dhe shijen. Ata fillojnë të lidhin botën përreth tyre me diturinë që janë duke e përfituar. Kjo periudhë i ndihmon ata të vërejnë modele, të bëjnë dallime dhe të vërejnë rregulla. Këto vëzhgime të thjeshta janë hapat e parë në zhvillimin e trurit të tyre. Manipulimi i objekteve ndihmon fëmijët të zhvillojnë lëvizjet e vogla dhe të mëdha.
- Ata shfaqin kuriozitet duke reaguar ndaj gjërave të reja, siç është tregimi me gisht ose prodhimi i tingujve. Kur shohin dhe reagojnë ndaj objekteve ose ngjarjeve të reja, ata tregojnë interes për të mësuar. Ky kuriozitet ndihmon shumë në zhvillimin e trurit të tyre duke i inkurajuar të eksplorojnë dhe të provojnë gjëra të reja përmes shqisave të ndryshme.
- Fëmijët zgjidhin probleme të thjeshta gjatë lojës, si përshtatja e blloqeve në një formë specifike. Lojërat me lodra që kërkojnë përshtatje ose rregullim ndihmojnë foshnjat të kuptojnë hapësirat dhe mënyrën se si gjërat përshtaten së bashku. Suksesi dhe dështimi në këto lojëra i mësojnë të rimëkëmben dhe të provojnë përsëri.

### Grup-mosha 3-4 vjeç

- Fëmijët fillojnë të bëjnë pyetje “pse” për botën përreth tyre. Pyetjet e tyre tregojnë kuriozitetin e tyre natyror dhe dëshirën për të kuptuar se si ndodhin gjërat. Bërja e pyetjeve i ndihmon ata të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në biseda, gjë që ndikon pozitivisht në zhvillimin e mendjes së tyre.
- Ata eksperimentojnë me materiale me përdorim të hapur, si blloqet, materialet e ricikluara, materialet natyrore dhe materialet për art. Kjo lloj loje u mundëson fëmijëve të mendojnë në mënyrë krijuese dhe të provojnë mënyra të reja për të bërë gjëra. Loja e lirë mbështet individualitetin dhe ndihmon në ndërtimin e vetëbesimit për të bërë zgjedhje.
- Ata zgjidhin probleme të thjeshta vetë, si përfundimi i sajuesve (puzzle) ose ndërtimi i kullave. Këto detyra i mësojnë fëmijët të jenë këmbëngulës dhe të mendojnë në mënyrë logjike. Zgjidhja e problemeve të lehta përmirëson aftësinë e tyre për të përballuar frustrimin dhe për të vazhduar deri në përfundim.

### Grup-mosha 5-6 vjeç

- Fëmijët krijojnë ide dhe strategji të reja për probleme më komplekse gjatë lojës ose detyrave të organizuara. Duke përdorur të menduarit kritik dhe kreativ për të zgjidhur probleme, ata gjejnë zgjidhje të shumta për një sfidë të vetme. Kjo i përgatit ata për jetën reale, ku kërkohet fleksibilitet dhe zgjuarsi.
- Fëmijët reflektojnë mbi veprimet dhe rezultatet e tyre. Për shembull, ata diskutojnë pse një zgjidhje funksionoi ose nuk funksionoi. Mendimi mbi atë që kanë bërë i ndihmon të kuptojnë më mirë veten. Ky hap e kthen mësimin nga gabimet në përparim domethënës (të mësuarit nga gabimet).
- Fëmijët punojnë me shokë e shoqe në projekte që kërkojnë ide të përbashkëta dhe krijimtari. Detyrat në grup u mësojnë atyre mësimin bashkëpunues, ndërsa ndajnë mendime dhe ndërtojnë punë në ekip. Këto projekte i ndihmojnë të mësojnë të negociojnë dhe të vlerësojnë kontributet e të tjerëve.



Mbështetja e krijimit të durimit, kureshtjes dhe këmbënguljes për të përfunduar detyrat ndërton aftësi të forta të fëmijës. Zgjidhja e hershme e problemeve krijon besim, gatishmëri për ndryshime dhe ndoshta edhe një dashuri të përhershme për të mësuar gjëra të reja.

### 3.2 Kompetenca për komunikim përmes gjuhëve verbale dhe joverbale

Aftësitë në fushën e gjuhës (përfshirë të shprehurit përmes gjuhës verbale dhe joverbale) ndërtohen në vitet e para të jetës. Këto aftësi përfshijnë një fushë të gjerë që nuk përfundon me përvetësimin e një gjuhe në aspektet e saj fonologjike, sintaksore, semantike dhe pragmatike, por përfshin aftësinë për ta përdorur komunikimin për të arritur të nxënit që lidhet me fusha të ndryshme të zhvillimit. Në këtë moshë, zhvillimi i gjuhës është i dukshëm jo vetëm si një fushë specifike që mundëson edhe zhvillimin e një game të gjerë aftësish, por edhe si lidhje e saj e thellë me zhvillimin e të menduarit në veçanti.

Duke njohur rëndësinë e gjuhës në komunikim, në krijim të raporteve me të tjerët, dhe në ndërtim të njohurive, pa marrë parasysh aspektin e gjuhës që është objekt analize dhe interpretimi, duhet të merret në konsideratë fakti se gjuha përdoret në situata sociale, duke iu përshtatur rregullave të përcaktuara

sociale, të cilat fëmija i mëson dhe zotëron me një shpejtësi të jashtëzakonshme.

Kompetenca gjuhësore nënkupton gatishmërinë për t'i zgjedhur, përdorur dhe zotëruar njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë në një kontekst të caktuar, për të ballafaquar dhe/ose zgjidhur një problem të dhënë. Në këtë kuptim, vjen në pah ndërgjegjësimi (metakognicioni) dhe përshtatja e gjuhëve komunikuese me kontekstin apo situatën.

Meqenëse të nxënit e vazhdueshëm në vitet e hershme përqendrohet në lojë si qasje kryesore për të nxënit, themelet e zhvillimit të fëmijës, burojnë gjithashtu nga loja. Mund të ketë përvoja të ndryshme dhe themelore të bazuara në eksperimentimin e gjuhëve kreative. Gjuhët që përdor fëmija në procesin e të nxënit pasqyrojnë proceset kreative dhe duhet të vlerësohen si një përvojë që ushqen dëshirën e fëmijëve për të mësuar përmes hulumtimit apo eksperimentimit.

Aktivitetet e lidhura me lojën, artin dhe eksperimentimin, janë mundësi për krijimin e këndvështrimeve të shumta, duke krijuar sinergji të pasura me mundësi. Dëgjimi, bërja e pyetjeve, reflektimi, shënimi, eksperimentimi, aktivitetet demonstruese, gabimet dhe fillimet e reja janë mundësi të hapura për ndërtimin e njohurive.

Fëmijët ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe zhvillojnë aftësi të përgjithshme gjatë lojës dhe komunikimit me bashkëmoshatarët.

Bashkëpunimi është thelbësor që fëmija të mësojë t'i zhvillojë aftësitë e të shprehurit

dhe artikullimit verbal dhe joverbal për të rritur vetëbesimin duke shprehur ndjenjat, mendimet, nevojat, interesat dhe kërkesat e tij\ saj. Është thelbësore të tregohet kujdes i veçantë për të inkurajuar dhe nxitur ndërveprimin midis fëmijëve që në moshë të hershme. Kjo mund të përjetohet gjatë lojës, aktiviteteve, sfiduese, hulumtuese dhe përvojave të tjera të përditshme. Ndërtimi i marrëdhënieve kuptimplota është thelbësor për fëmijën, veçanërisht në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, pasi i jep atij\ asaj një ndjenjë përkatësie dhe i jep mundësi për të zhvilluar vetëvlerësimin. Loja dhe bashkëveprimi do t'i rrisë aftësitë e tij\ saj sociale dhe aftësinë për të krijuar marrëdhënie me të tjerët. Kjo do ta lejojë atë të shoh botën nga këndvështrimi i një personi tjetër. Në këtë mënyrë, fëmija do të mësojë t'i respektojë pikëpamjet e të tjerëve, t'i orientojë sjelljet e veta të ardhshme dhe të gjejë strategji më të mira dhe më të larmishme kur ballafaqohet me situata të ndryshme në jetën e përditshme.

Komunikimi është një aftësi thelbësore që fëmija përvetëson gjatë zhvillimit të marrëdhënieve me moshatarët, të rriturit, edukatorët dhe komunitetin që e rrethon. Ai\ ajo zhvillon aftësi të komunikimit verbal dhe joverbal për të shprehur ndjenjat, mendimet, të drejtat dhe kërkesat e tij\ saj. Është thelbësore të tregohet kujdes i veçantë për të inkurajuar dhe nxitur ndërveprimin midis fëmijëve që në moshë të hershme. Fëmija fiton dhe zhvillon komunikimin dhe gjuhën amtare nëpërmjet marrëdhënieve me prindërit\ kujdestarët ligjorë të tyre, fëmijët e tjerë dhe edukatorët. Edukatori\ ja duhet të jetë i\ e vetëdijshëm për rëndësinë dhe rolin e tyre dhe t'i kushtojnë vëmendje cilësisë së gjuhës që përdorin me fëmijën (përdorimin e drejtë, të saktë të gjuhës standarde dhe të kuptueshme për moshën e fëmijëve). Gjuha mund të modelohet gjatë lojës, aktiviteteve hulumtuese dhe eksploruese dhe përvojave të përditshme. Fëmijës duhet t'i jepet mundësi bashkëpunimi, ndërveprimi dhe komunikimi në mjedise miqësore, të sigurt, të besueshme dhe të natyrshme sa më shumë që të jetë e mundur.

Komunikimi është një nga kompetencat që e ndihmon fëmijën të bashkëjetojë dhe të



ndërveprojë me të tjerët në çështje dhe situata të ndryshme jetësore, ndaj duhet zhvilluar në mënyrë të organizuar dhe sistematike. Për të zhvilluar këtë kompetencë, fëmija duhet të mbështetet në shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve të tij\ saj, në shprehjen e asaj që është interesante për të dhe në zberthimin e asaj se çfarë bën, mendon, ndjen dhe ndan.

Në këtë kontekst, vëmendje duhet t'i kushtohet zhvillimit të shprehjeve përmes të folurit në gjuhën amtare, shprehjeve joverbale, mbështetjes së fëmijës në bisedë, ndërtimit të të kuptuarit të plotë dhe zhvillimit të njohurive për konceptet e jetës së përditshme, si dhe të shprehurit nëpërmjet të folurit në një gjuhë të huaj, për të cilën fëmija tregon interes.

Aktivitetet zbavitëse dhe të lojës e ndihmojnë fëmijën të komunikojë lirshëm dhe në mënyrë spontane për çështje reale dhe të imagjinuara. Kujdes duhet pasur në komunikimin elektronik sepse në shekullin e digjitalizimit, fëmija është vazhdimisht i ekspozuar ndaj mjeteve digjitale.

Gjatë zhvillimit të kompetencës së komunikimit, vëmendje duhet t'i kushtohet respektimit të mendimeve të të tjerëve, dëgjimit dhe të folurit me radhë nga ana e tyre.

Pyetjet, idetë e shprehura nga fëmijët apo problemet që parashtrajnë për t'i zgjidhur janë mënyra më e mirë për të mësuar duke komunikuar. Kjo nënkupton që fëmija planifikon dhe bën zbulime, jep shpjegime, zgjidhë dhe kupton koncepte në mënyra të ndryshme dhe domethënëse.

**Gjuhët shprehëse** janë të rëndësishme dhe thelbësore në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe paraqesin tregues vendimtar të elementeve të zhvillimit të fëmijës të tilla si: lëvizja (aftësitë e shkëlqyera motorike),

iniciativa, imagjinata, aftësia, mënyra se si e percepton dhe pasqyron botën, informacionet për temat përkatëse, konteksti social dhe kulturor. Gjuhët shprehëse janë po ashtu edhe një matës i mirë i zhvillimit emocional të fëmijës.

Metafora e **100 gjuhëve të fëmijës**, marrë nga qasja “Reggio Emilia”, është një metaforë e rëndësishme për ta kuptuar të shprehurit e fëmijës. Me lojën dhe punën e fëmijës, realiteti dhe fantazia e tij\ saj, shkenca dhe imagjinata, qielli dhe toka, arsyeja dhe ëndrra bëhen bashkë. Kreativiteti nuk e ndan fantazinë nga procesi kognitiv apo i të nxënit ose emocionet nga racionaliteti. Fëmija duhet ta ketë mundësinë të punojë me gjuhë shprehëse si potencial për të mësuar dhe zhvilluar shumë aftësi emocionale, bashkëvepruese, shqisore dhe intelektuale në vazhdimësi dhe përshtatshmëri me realitetin kulturor dhe social.

Fëmija është një ndërtues i njohurive, të cilat ai i formëson dhe shtjellon përmes përvojës dhe lojës që zhvillon.

Detyra e institucionit të edukimit në fëmijërinë e hershme është që gradualisht ta zhvilloj potencialin e fëmijës, jo vetëm për të lënë atë ta shprehë në mënyrë krijuese, por edhe për ta bërë atë të aftë, nëpërmjet ndërveprimit të “njëqind gjuhëve”, për të nxënë dhe për të qenë ndërtues aktiv i njohurive. Metodatat e komunikimit (verbal, joverbal dhe paraverbal) duhet të përdoren në mënyrë të harmonizuar për të lehtësuar marrëdhëniet dhe komunikimin me bashkëbiseduesit e tjerë përmes një shumëllojshmërie të gjuhëve dhe të nxënit.

Përgatitja e fëmijëve për leximin e hershëm fillon me një mjedis të pasur me gjuhë. Ky mjedis ushqen kureshtjen e tyre dhe ndërton aftësi bazë. Dashuria për librat është shumë e rëndësishme.

Leximi për fëmijët çdo ditë me zëra shprehës dhe histori tërheqëse, tërheq vëmendjen e tyre dhe e bën leximin argëtues. Kjo metodë u prezanton fjalë të reja dhe përmirëson aftësitë e tyre dëgjimore. Ofrimi i shumë librave, si libra me figura, tregime me rimë dhe libra interaktivë, i ndihmon të eksplorojnë dhe të zhvillojnë interesin për gjuhën e shkruar.

Të folurit është kyç për leximin e hershëm. Bisedat, bërja e pyetjeve me përgjigje të hapura dhe inkurajimi i përshkrimeve ndihmojnë në rritjen e fjalorit dhe të kuptuarit. Këngët dhe rimat mbështesin ndërgjegjësimin fonemik duke ndihmuar fëmijët të dëgjojnë tingujt në fjalë. Kjo është shumë e rëndësishme.

Futja graduale e shkrimit të emrave ose gjurmimit të shkronjave lidh gjuhën e folur me atë të shkruar. Aktivitetet e leximit të tregimeve mund të përfshijnë parashikimin e përfundimeve të tregimeve ose ritregimin. Këto jo vetëm që mbështesin të kuptuarit, por gjithashtu përmirësojnë aftësitë e renditjes dhe tregimit të historive. Një rutinë e përditshme me kohë leximi vendos zakone për t’u angazhuar me tekstet dhe tregimet në moshë të hershme.

Puna me familjet është gjithashtu thelbësore. Ndarja e këshillave me prindërit, si të lexojnë me fëmijët e tyre, të luajnë lojëra me tinguj dhe të kenë libra në shtëpi, siguron një



### Vëmendje për edukatorët

Edukatorët/et duhet të flasin dhe të ndërveprojnë me fëmijët për të ndërtuar aftësitë e të folurit dhe të gjuhës së trupit. Ata/ato duhet të përdorin fjalë të thjeshta që i përshtaten moshës së fëmijës dhe t’i kërkojnë fëmijëve të ndajnë mendimet e tyre me fjalë, lëvizje duarsh dhe shprehje të fytyrës. Tregimi i historive, këndimi dhe aktrimi në lojëra ndihmojnë fëmijët të pasurojnë fjalorin, aftësitë e tregimit dhe guximin për t’u shprehur dhe për të ndarë idetë me të tjerët.

Edukatorët duhet të dëgjojnë me mirësi dhe të vërejnë sinjalet e trupit të fëmijëve, si lëvizjet e tyre ose shprehjet e fytyrës. Lojërat në grup ku fëmijët dëgjojnë, presin radhën dhe i përgjigjen të tjerëve u mësojnë atyre se si njerëzit flasin dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Fëmijët kanë nevojë për mundësi për të provuar mënyra të ndryshme për të shprehur ndjenjat dhe idetë e tyre, si piktura, muzika, vallëzimi dhe aktrimi. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijët të shprehin emocionet dhe mendimet në mënyra argëtuese dhe krijuese.



## Qëllimet për të nxënit për Kompetencën 2: Komunikimi përmes gjuhëve verbale dhe joverbale

### Grup-mosha 0-2 vjeç

- Fëmijët përdorin gjeste dhe fjalë të thjeshta për të shprehur nevojat, si të tregojnë me gisht apo të thonë fjalë të thjeshta. Format e hershme të komunikimit, si tregimi me gisht apo belbëzimi, krijojnë bazën për zhvillimin e gjuhës. Këto shkëmbime të thjeshta ndihmojnë kujdestarët dhe fëmijët të ndërtojnë lidhje përmes mirëkuptimit të ndërsjellë. Ky proces është shumë i rëndësishëm për marrëdhënien dhe krijimin e raporteve fëmijë - i rritur.
- Ata imitojnë tinguj dhe fjalë për të mësuar gjuhën. Përsëritja dhe kopjimi janë kyçe për zotërimin e tingujve dhe ritmeve të të folurit. Kjo fazë u mundëson fëmijëve të praktikojnë formimin e fjalëve. Të folurit qartë është thelbësor.
- Fëmijët bashkohen në aktivitete si loja “kukafshehas” apo këndimi me veprime. Këto ndërveprime u mësojnë rregullat sociale, si të presin radhën dhe pikat bazë të bisedës. Veprimet argëtuese ndihmojnë fëmijët të lidhin gjuhën me lëvizjet.

### Grup-mosha 3-4 vjeç

- Fëmijët formojnë fjali të thjeshta për të shprehur nevoja, ide ose ndjenja. Ata fillojnë të përdorin fjali për të ndarë atë që mendojnë, duke kaluar nga përdorimi i fjalëve të vetme. Kjo aftësi i ndihmon të komunikojnë me të tjerët në grupe, një aftësi shumë e rëndësishme. Gjithashtu, e përdorin këtë aftësi për të ndarë atë që u pëlqen ose si ndjehen.
- Ata përdorin shenja joverbale, si shprehjet e fytyrës dhe gjestet, për të ndihmuar komunikimin. Kuptimi i këtyre shenjave ndihmon fëmijët të lidhen me të tjerët kur të folurit ende është i vështirë. Sinjalet joverbale janë thelbësore për të shprehur ndjenja si gëzimi, frustrimi ose kureshtja.
- Ata marrin pjesë në tregime në grup ose në lojëra me role. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijët të përdorin imagjinatën e tyre dhe të provojnë kreativitetin. Loja me role u mundëson të krijojnë tregime të reja dhe të praktikojnë aftësitë e të folurit dhe të menduarit. Këto aftësi zhvillohen përmes këtyre aktiviteteve. Tregimet në grup u mësojnë bashkëpunimin dhe i ndihmojnë fëmijët të shtojnë ide mbi ato që ndajnë të tjerët.

### Grup-mosha 5-6 vjeç

- Fëmijët përdorin fjali të detajuara për të përshkruar mendime, ndjenja dhe përvoja. Në këtë fazë, ata rrëfejnë ngjarje shkurt dhe qartë, shpesh duke përfshirë renditje dhe detaje. Kjo aftësi mbështet përgatitjen për shkollë dhe komunikimin shoqëror.
- Ata marrin pjesë në biseda me të tjerët, duke treguar aftësi për të dëgjuar dhe për të respektuar radhën. Të mësuarit për të dëgjuar dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të duhur është kyç për miqësitë dhe për mjedisin e grupit/klasës. Këto biseda nxisin empatinë dhe aftësinë për të parë gjërat nga këndvështrime të ndryshme.
- Ata fillojnë të provojnë tregimin e historive, duke përdorur imagjinatën për të krijuar tregime me pjesë të folura dhe të pathëna. Tregimi krijues përzien aftësitë shprehëse dhe rendin logjik, duke ndihmuar fëmijët të ndajnë idetë e tyre në mënyra argëtuese. Ai gjithashtu i ndihmon të përdorin mënyra të ndryshme komunikimi, si gjestet apo vizatimet.

përvojë të qëndrueshme edukative. Vizitat familjare në biblioteka u ekspozojnë fëmijëve më shumë materiale leximi. Strategjitë e kombinuara përmirësojnë ndërgjegjësimin fonemik, fjalorin dhe të kuptuarit e hershëm të fëmijëve.

Kultivimi i dashurisë për librat, zhvillimi i gjuhës së folur, ndërtimi i ndërgjegjësimit fonemik, ofrimi i një mjedisi të pasur me materiale të shtypura dhe zhvillimi i aftësive motorike të imta përgatitin fëmijët për një lexim të suksesshëm. Aktivitetet interaktive dhe përpjekjet familjare krijojnë një bazë të fortë për suksesin e ardhshëm në lexim.

### 3.3 Kompetenca socio-emocionale

Vitet e para të jetës së një fëmije janë mundësi unike për të nxitur zhvillimin e shëndetshëm. Kërkimet shkencore nënvizojnë rëndësinë e viteve të para të jetës për përvojat pozitive dhe negative në formësimin e aftësive kognitive, të sjelljes, sociale dhe emocionale të fëmijës. Shkenca ka zbuluar se ndikimi i fuqishëm i përvojës së hershme në ndërtimin e trurit i bën vitet e para të jetës një periudhë të mundësive të mëdha, por njëkohësisht edhe vite të cenueshmërisë së lartë për zhvillimin e trurit.

Që nga lindja, fëmijët nisin të zhvillojnë aftësi që janë thelbësore për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe për menaxhimin e emocioneve të tyre. Zhvillimi emocional dhe social përfshin ndërgjegjësimin për emocionet personale, aftësinë për të njohur dhe për të kuptuar ndjenjat e të tjerëve, si dhe ndërtimin e sjelljeve që ndihmojnë në krijimin e lidhjeve pozitive me të tjerët. Këto ndërveprime përfshijnë komunikimin, lëvizjet fizike (gjuhën e trupit), bisedën, lojën me të tjerët, bashkëpunimin, zgjidhjen e konflikteve dhe aftësi të tjera thelbësore për përshtatjen mjedisore në të ardhmen.

Studimet kanë zbuluar tashmë se zhvillimi socio-emocional është i lidhur ngushtë me zhvillimin kognitiv (apo njohës). Së bashku, këto ndërtojnë bazën për zhvillimin e marrëdhënieve, përballimin e situatave stresuese, zgjidhjen e problemeve, kontrollin e shpërthimeve emocionale dhe shumë aftësi



të tjera.

Sjellja sociale dhe ndërtimi i marrëdhënieve pozitive konsiderohen tradicionalisht aftësi që zhvillohen natyrshëm te fëmija. Këto aftësi zhvillohen dhe lulëzojnë së pari në mjedise të ngrohta familjare dhe vazhdojnë në mjedise të edukimit të hershëm. Të jetosh në një mjedis të besueshëm shoqëror, rrit gjasat që një fëmijë të zhvillojë marrëdhënie pozitive dhe të integrohet lehtësisht në çdo mjedis shoqëror në të ardhmen.

Një pjesë e rëndësishme e zhvillimit emocional është aftësia për të njohur dhe për të identifikuar emocionet. Fëmijët kanë nevojë të mësojnë se çfarë janë emocionet që ndiejnë dhe si t'i emërtojnë ato. Fëmijët shpesh hasin vështirësi për të gjetur fjalët e duhura për të shprehur ndjenjat e tyre, gjë që mund të çojë në zhgënjim dhe vetëdije dhe komunikim të pamjaftueshëm të emocioneve.

Fëmija është i aftë për të ndërtuar dhe demonstruar vetërregullim emocional (që lidhet me menaxhimin e rrezikut dhe këmbënguljen), është aktiv në aspektin metakognitiv, emocional, motivues dhe të sjelljes brenda procesit të tij/saj të të nxënit. Kështu, vetërregullimi është një term i përgjithshëm që përfshin edhe metakognicionin. Vetërregullimi është një aftësi që e lejon fëmijën të menaxhojë emocionet, sjelljen dhe lëvizjen e trupit kur përballet me një situatë të vështirë. Vetërregullimi në vete përfshin menaxhimin e emocioneve të ndryshme (si p.sh. gëzimit, hidhërimit, zemërimit, frikës), shkathtësitë e negociimit dhe shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve. Por, nuk duhet shikuar asnjëherë si një aftësi e vetme. Në të vërtetë është një mori e tërë aftësish. Në qendër të këtyre aftësive është aftësia për të kontrolluar diçka

- një sjellje, një mendim, një impuls, lëvizje ose një ndjenjë.

Vetërregullimi emocional dhe social dhe ndërveprimet me të tjerët i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë empatinë, të kuptojnë perspektivat e të tjerëve dhe të ndërtojnë aftësitë e nevojshme për t'u bërë pjesë e një grupi. Ndërtimi i empatisë nënkupton zhvillimin e aftësisë për të kuptuar emocionalisht se çfarë ndjejnë të tjerët, të shohim gjërat nga këndvështrimi i tyre dhe të imagjinojmë veten në vendin e tyre. Empatinë mund ta zhvillojmë në fëmijërinë e hershme duke modeluar vet sjellje empatike, duke i emëruar dhe duke folur për ndjenjat, duke i pranuar emocionet e fëmijës, duke shpjeguar si po ndihemi, duke treguar përralla për ndjenjat, e kështu me radhë.

Edukatorët përforcojnë shkathtësitë pozitive sociale dhe nxisin lojën bashkëpunuese në një mjedis emocionalisht përkrahës për formësimin e sjelljeve pozitive dhe shoqërore. Megjithatë, konfliktet mund të ndodhin edhe në mjediset më pozitive, më përkrahëse dhe më të hapura, dhe si të tilla pengojnë rutinën e fëmijës dhe mund të çojnë në dhunë. Për t'i mësuar fëmijës strategji të zgjidhjes së konfliktit, përpos që duhet të modelojmë sjellje pozitive, e ndihmojmë atë të shpreh me fjalë ndjenjën e tij\ saj, luajmë lojë me role dhe ushtrojmë skenarë konflikti, ndajmë me të praktikatat e mira të zgjidhjes së konflikteve përmes tregimeve dhe përrallave, i mësojmë teknika relaksimi, etj.

Kompetenca socio-emocionale përfshin edhe tolerancën dhe pranimin e diversitetit

- që i referohet qëndrimeve të hapura dhe respektimit të dallimeve që ekzistojnë mes njerëzve. Nënkupton që fëmija i respekton dhe mëson nga të tjerët, i vlerëson dallimet, nuk bën stereotipizime dhe është i gatshëm të shoqërohet me të gjithë fëmijët pa dallime. Fëmija i të gjitha moshave zhvillon vlerat e tij\ saj, në pjesën më të madhe, duke pasqyruar vlerat dhe qëndrimet e atyre që kujdesen për të.

Zhvillimi i aftësive sociale dhe demonstrimi i marrëdhënieve pozitive i mundëson fëmijës të zhvillohet në një trajektore të shëndetshme dhe të qëndrueshme socio-emocionale dhe përmirëson përshtatjen dhe arritjet pozitive duke filluar në familje, institucion të EFH-së dhe në komunitet në vazhdimësi.

Këto aftësi përfshijnë aftësitë ndërpersonale, aftësitë e komunikimit verbal dhe joverbal, inteligjencën emocionale, sensin e iniciativës, apo ndërmarrësisë, dhe kreativitetin, etj.

Të nxënit socio-emocional është çelësi i ndjenjës së vetëefikasitetit, duke gjeneruar iniciativë dhe këmbëngulje. Ky komponent zhvillimor i fëmijës përfshinë ndjenjën personale të pavarësisë, aftësinë për menaxhimin e rrezikut dhe ndërveprimin me të tjerët. Fëmija duhet të mbështetet në procesin e pavarësisë, duke marrë iniciativën dhe duke menaxhuar rreziqet e ndërlidhura. Ky zhvillim emocional dhe social është i lidhur ngushtë me mënyrën se si ata ndihen të sigurt dhe të përkrahur në mjedisin e tyre, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndërtimin e një vetëvlerësimi dhe vetëbesimi të qëndrueshëm.



### Vëmendje për edukatorët

Edukatoret kanë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të kujdesshëm për fëmijët. Ato mbështesin ndjenjat dhe miqësitë mes fëmijëve. Fëmijët mësojnë të kuptojnë emocionet e tyre përmes tregimeve, vizatimeve ose bisedave. Për shembull, edukatoret mund të thonë: “Duket sikur je i mërziur; mund të më tregosh pse?” Edukatoret tregojnë mirësjellje dhe empati, duke i inkurajuar fëmijët të vërejnë dhe të reagojnë ndaj emocioneve të të tjerëve.

Lojërat në grup u mësojnë fëmijëve të ndajnë, të respektojnë radhën dhe të zgjidhin problemet me ndihmën e të tjerëve. Fëmijët i zhvillojnë këto aftësi gjatë lojës. Praktika si frymëmarrja e thellë ose gjetja e një vendi të qetë i ndihmon fëmijët të qetësohen. Kjo metodë inkurajohet vazhdimisht.

Diversiteti duhet të kultivohet në klasë. Fëmijët mësojnë të respektojnë ndryshimet dhe të punojnë së bashku. Këto mësimë mbi përfshirjen janë shumë të vlefshme. Edukatoret që modelojnë sjellje të mira sociale ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi të forta sociale.



## Qëllimet për të nxënit për Kompetencën 3: **Kompetenca Socio-Emocionale**

### Grup-mosha 0-2 vjeç

- Fëmijët tregojnë një të kuptuar bazë të emocioneve, si të qeshurit kur janë të lumtur ose të qarit kur janë të mërzitur. Njohja e ndjenjave dhe reagimi ndaj tyre i ndihmon fëmijët të lidhen me kujdestarët dhe të kuptojnë më mirë emocionet. Kjo fazë është fillimi i empatisë dhe menaxhimit të ndjenjave.
- Ata identifikojnë njerëz të njohur dhe krijojnë lidhje të forta. Lidhjet e sigurta sjellin besim dhe ndjenjë sigurie, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e shëndetshëm emocional. Këto lidhje i inkurajojnë fëmijët të eksplorojnë botën e tyre me vetëbesim.
- Ata luajnë pranë bashkëmoshatarëve në lojë paralele. Të luajturit pranë fëmijëve të tjerë i fut ata në mjediset sociale pa stresin e ndërveprimit të drejtpërdrejtë. Ky është hapi i parë përpara lojës më bashkëpunuese.

### Grup-mosha 3-4 vjeç

- Fëmijët identifikojnë dhe emërtojnë emocionet bazë të vetja dhe të tjerët, si lumturia, trishtimi ose zemërimi. Ky kuptim i ndihmon ata të flasin për ndjenjat në mënyrë të qartë dhe të menaxhojnë ndërveprimet sociale. Emërtimi i emocioneve ndihmon në uljen e frustrimit gjatë momenteve të vështira. Emocionet kanë shumë rëndësi.
- Ata ndajnë lodrat dhe respektojnë radhën me miqtë gjatë kohës së lojës. Këta hapa të hershëm drejt bashkëpunimit i mësojnë fëmijët si të mendojnë për nevojat e të tjerëve dhe të zhvillojnë zakone të mira sociale. Të ndarit e gjërave ndihmon në krijimin e një ndjenje drejtësie dhe empatie.
- Ata praktikojnë kontrollin e vetes në situata të thjeshta, si të presin me durim radhën e tyre. Kjo praktikë u mëson durimin dhe i ndihmon të kontrollojnë impulsivitetin, duke i përgatitur për aktivitete të organizuara në grup dhe lojëra ekipore. Vetërregullimi është shumë i dobishëm.

### Grup-mosha 5-6 vjeç

- Fëmijët tregojnë mirëkuptim duke reaguar në mënyrë të duhur ndaj ndjenjave të të tjerëve. Empatia krijon miqësi të forta dhe i ndihmon fëmijët të bashkëpunojnë më mirë. Ata fillojnë të vërejnë nevojat e të tjerëve, ofrojnë ndihmë dhe bashkëndejnë.
- Fëmijët shmangin sjelljet emocionale stereotipike të bazuara në gjini, si “djemtë duhet të jenë të fortë dhe të mos qajnë kurrë.”
- Ata bashkëpunojnë me shokët dhe shoqet e grupit për të zgjidhur mosmarrëveshjet me pak ndihmë. Zgjidhja e problemeve i mëson fëmijët të ndajnë ndjenjat në një mënyrë të sjellshme dhe të gjejnë një zgjidhje të përbashkët. Këto mësimet ndërtojnë aftësi të rëndësishme për të bashkëpunuar dhe për të gjetur zgjidhje.
- Ata tregojnë më shumë pavarësi në qetësimin e vetes kur ndjehen të shqetësuar. Menaxhimi i emocioneve në mënyrë të pavarur forcon vetëbesimin dhe i përgatit fëmijët për sfidat e shkollës dhe të krijimit të miqësive.

### 3.4 Kompetenca për shkencë, teknologji, dhe logjikë

Shkenca dhe teknologjia janë faktorë të padiskutueshëm të botës së sotme. Teknologjia mbështet marrëdhëniet sociale dhe ato ekonomike; prandaj, qasja universale në këto njohuri është e nevojshme. Duke përdorur teknologjitë gjatë edukimit në fëmijëri të hershme, mund të mbështetet jeta e përditshme duke krijuar hapësira digjitale si një burim që pasuron dhe mjet për transformimin e kontekstit.

Në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme si dhe në jetë të përditshme, përdorimi i komunikimeve digjitale është bërë nevojë e kohës. Po përjetojmë një “normalitet” të ri në një det pasigurish. Ndërgjegjësimi në lidhje me këtë nevojë kërkon përdorim të teknologjisë jo për ta zëvendësuar punën e deritanishme, por për ta përdorur atëherë kur dhe në mënyrën që është e dobishme për procesin pedagogjik.

Manipulimi dhe eksperimentimi me materiale të natyrave, formave dhe vëllimeve të ndryshme ua mundëson fëmijëve të ndërtojnë gradualisht mendime konceptuale dhe të parafytyrojnë. Në mjediset e edukimit në fëmijërinë e hershme, fëmija mund të hasë në të mësuarit tërthor (njohje, kategorizim, përzgjedhje dhe planifikim).

Të menduarit logjik duhet të inkurajohet nëpërmjet hulumtimit apo eksplorimit spontan dhe stafi edukativ duhet ta pranojë hapur dhe të fuqizoj kureshtjen e fëmijëve. Zhvillimi i kompetencës logjiko-matematikore në EFH është thelbësor për vendosjen e një themeli të fortë për aftësitë matematikore dhe zgjidhjen e problemeve. Konceptet logjike- matematikore duhet të hulumtohen dhe identifikohen në jetën e përditshme gjatë dhe përmes situatave ku fëmija është protagonist i eksplorimit dhe i rrituri zbulon apo krijon situata tërheqëse për eksplorim nga fëmijët. Prandaj, edhe matematika nuk duhet kuptuar si një disiplinë normash dhe rregullash, por si përvoja që vazhdimisht janë në zhvillim dhe në marrëdhënie me njëra-tjetrën.



Loja nënkupton mësim; fëmija mëson duke luajtur. Përmbajtja edukative në institucionet e EFH-së zhvillohet përmes lojës, e cila është definuar si parim edhe në Ligjin e ri për EFH<sup>1</sup>. Loja spontane dhe e vetëorganizuar e fëmijës duhet të njihet dhe të mbështetet nga edukatorët. Loja vjen natyrshëm nga fëmija pasi që në moshë të hershme ai\ajo tërhiqet nga gjithçka që e rrethon dhe eksploron mbi të.

Fëmija argëtohet dhe zhvillohet në të njëjtën kohë gjatë lojës. Logjika dhe imagjinata e fëmijës krijohet përmes lojës. Lojërat që luan fëmija kanë një rol thelbësor në jetën e tij\ saj dhe kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e fëmijës. Loja është një aktivitet argëtues vullnetar i bazuar në motivimin e brendshëm të fëmijës në të cilin ai/ajo angazhohet në mënyrë aktive. Nëpërmjet lojës, fëmija mëson për botën dhe përjeton ndjenja të ndryshme; përmes saj plotësohen nevojat dhe interesat e fëmijës. Me ndihmën e lojës, fëmija zhvillon kompetencat e të nxënit, gjë që ndikon në rritjen e vetëbesimit dhe qëndrueshmërinë e të nxënit.

Në edukimin në fëmijëri të hershme, loja krijon bazën për zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës.

Rëndësia e lojës në fëmijërinë e hershme është thelbësore në rritjen e tyre, si dhe stimulimin e zhvillimit të hershëm të trurit, përmirëson të kuptuarit, inkurajon të menduarit kreativ, zhvillon komunikimin, pasuron gjuhën dhe fjalorin, promovon vetëkontrollin dhe vetërregullimin emocional, rrit kompetencën dhe ndjeshmërinë sociale, përmirëson shëndetin fizik dhe mendor dhe vlerëson kulturën e fëmijës.

<sup>1</sup> Ligji Nr. 08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2023). Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79000>



## Vëmendje për edukatorët

Edukatorët duhet të frymëzojnë të nxënëit duke bërë pyetje dhe duke eksploruar së bashku. Fëmijët rriten në mendimin shkencor përmes lojës dhe eksperimenteve. Aktivitetet praktike u lejojnë atyre të provojnë gjëra vetë. Fëmijët shijojnë të zbulojnë pse objektet notojnë ose fundosën, të mbjellin fara ose të ndërtojnë struktura të thjeshta. Mjetet si lupa, shkallët dhe teknologjia fillestare ndihmojnë që eksplorimi të ndihet argëtues dhe i gjallë. Pyetjet dhe parashikimet ndihmojnë fëmijët të testojnë ide dhe të mendojnë në mënyrë kritike. Një mendësi kureshtarë zhvillohet kur fëmijët bëjnë pyetje. Lojërat dhe sajueset (puzzle) me modele ose sekuenca ndihmojnë arsyetimin e tyre logjik. Mjetet digjitale u mësojnë përgjegjshmëri dhe kreativitet. Poashtu, aventurat digjitale gjithashtu tregojnë një mënyrë të re për të dokumentuar të nxënëit.



Qëllimet për të nxënëit për Kompetencën 4:

### Kompetenca për shkencë, teknologji, dhe logjikë

#### Grup-mosha 0-2 vjeç

- Fëmijët zbulojnë pse një gjë çon në një tjetër, si shtypja e një butoni për të dëgjuar muzikë. Testet e hershme me shkak dhe pasojë i ndihmojnë fëmijët të mësojnë si veprimet ndryshojnë botën e tyre. Ata kanë nevojë për këto aktivitete për të ndihmuar zhvillimin e mendimit logjik.
- Ata ndërveprojnë me materiale të pasura nga ana shqisore, si loja me ujë ose grumbullimi i blloqeve. Lojërat sensorike u lejojnë fëmijëve të manipulojnë gjëra dhe të gjejnë mënyra për të zgjidhur probleme. Kjo fazë është shumë e rëndësishme për aftësitë motorike dhe zhvillon një kureshtje të thellë.
- Ata kopjojnë veprime të thjeshta të lidhura me teknologjinë, si pretendimi se si të përdorin një telefon. Vëzhgimi dhe kopjimi i veprimeve të hershme ndihmon fëmijët të kuptojnë se si pajisjet dhe mjetet bëjnë pjesë në aktivitete të përditshme.

#### Grup-mosha 3-4 vjeç

- Fëmijët bëjnë pyetje të thjeshta për të kuptuar si funksionojnë gjërat. Mësimi bazuar në pyetje përmirëson mendimin e tyre kritik dhe lidh ide të ndryshme. Kjo gjithashtu nxit dashurinë për të mësuar dhe për të zbuluar gjëra të reja.
- Ata eksperimentojnë me modele dhe sekuenca, si të renditin ngjyra, forma ose numra. Këto aktivitete ndihmojnë shumë në ndërtimin e një baze të fortë për aftësitë matematikore dhe mendimin logjik. Njohja e modeleve gjithashtu zhvillon mendimin fleksibël.
- Ata përdorin teknologji që është e përshtatshme për moshën e tyre, si aplikacione edukative, me mbikëqyrje. Teknologjia u lejon fëmijëve të mësojnë në mënyrë interaktive, duke i njohur me botën digjitale dhe praktikatat e përdorimit të sigurt të pajisjeve digjitale.

#### Grup-mosha 5-6 vjeç

- Fëmijët parashikojnë se çfarë mund të notojë ose të zhytet gjatë eksperimenteve. Bërja e eksperimenteve praktike zgjon kuriozitetin dhe mbështet mendimin shkencor. Parashikimi i rezultateve lejon fëmijët të mësojnë si të testojnë ide. Fillon të kuptuarit e koncepteve të thjeshta fizike.
- Ata zgjidhin probleme logjike duke gjetur modele, duke kategorizuar dhe krijuar sekuenca. Këto detyra për zgjidhjen e problemeve ndihmojnë në ndërtimin e aftësive të arsyetimit. Kjo është e rëndësishme për suksesin e ardhshëm në matematikë dhe shkencë.
- Ata përdorin mjete si tableta dhe kamera digjitale për të eksploruar dhe kapur momente të të nxënëit. Përdorimi kreativ i teknologjisë përmirëson aftësitë për eksplorim dhe paraqitje apo dukumentim. Kjo inkurajon një ndërveprim më të thellë me mjedisin e tyre.

### 3.5 Kompetenca për qytetari globale

Të menduarit e fëmijës zhvillohet përmes ndërveprimeve, shkëmbimeve, dhe dialogjeve. Edukimi i hershëm për qëndrueshmëri ia mundëson fëmijës të vlerësojë dhe respektojë mjedisin natyror, të jetë i përgjegjshëm për mjedisin, ta kuptojë ndërvarësinë midis njerëzve, bimëve, kafshëve dhe tokës, të ndërveprojë me bimët dhe materialet natyrore në mjedis. Në këtë mënyrë, fëmija zhvillon të kuptuarit për biodiversitetin dhe kupton ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedis dhe natyrë. Fëmija ka një vetëdije dhe kompetencë të lindur, të natyrshme ndaj bashkëpunimit dhe kjo kompetencë gradualisht kalon në njohjen individuale.

Fëmija ka bashkëpunim të lindur dhe të pakufizuar me elementin natyror dhe i ndërton njohuritë e tij\ saj shumë më mirë kur i ndërlidh ato me mjedisin natyror dhe ekologjinë. Duhet të kemi parasysh se elementet natyrore nuk kundërshtohen me elementin njerëzor. Qëllimi i edukimit për qëndrueshmëri është shfaqur si një përgjigje ndaj shqetësimeve në rritje për jetën njerëzore, si: tërmetet, ndryshimet klimatike, ngrohja globale, thatësira, mungesa e ujit, ndotja e ajrit, mungesa e ushqimit dhe ruajtja e mjedisit.

Përqendrimi në qëndrueshmërinë klimatike në edukimin e fëmijëve fillon me lidhjen e fëmijëve me natyrën. Aktivitetet si kopshtaria, mbjellja e pemëve dhe eksplorimi jashtë ndihmojnë që ata të bëhen më të vetëdijshëm për natyrën. Ide të thjeshta për ndryshimet klimatike dhe kujdesin për planetin mund të shprehen përmes tregimeve. Këto histori mund të përfshijnë shembuj nga natyra e Kosovës. Të nxënit përmes praktikës, si riciklimi dhe ripërdorimi i gjërave gjatë aktiviteteve artistike dhe lojërave, u mëson fëmijëve zakone të qëndrueshme në një mënyrë argëtuese. Klasa\grupi dhe kopshti ka krijuar ambiente të gjelbërta duke përdorur materiale të sigurta dhe duke ulur mbeturinat. Kjo i mëson fëmijët për qëndrueshmërinë çdo ditë. Projektet për kursimin e ujit dhe energjisë përdorin lojëra dhe këngë. Këto i mbajnë ato emocionuese dhe të paharrueshme për fëmijët. Familjet marrin pjesë duke përdorur kuti ushqimi të ripërdorshme ose



duke zgjedhur ecjen dhe biçikletat. Vizitat në ferma, pyje ose lumenjë ndihmojnë fëmijët të kuptojnë se si natyra punon së bashku dhe se si njerëzit e ndikojnë mjedisin.

Në këtë kompetencë, me vetëdije përfshijmë kompetencat e qytetarisë globale, të kuptuara gjerësisht si bazë e harmonisë me thelbin tonë njerëzor. 'Qytetaria' është bërë gjithashtu një pjesë themelore e edukimit që në fëmijërinë e hershme, e cila rrjedhë nga krijimi i politikave deri te zbatimi i tyre për kujdesin dhe edukimin e fëmijës.

Supozimi se njëra nuk mund të ekzistonte pa tjetrën ka kontribuar në përhapjen e konceptit të 'qytetarisë' për fëmijën. Duke u dhënë atyre të drejta të pjesëmarrjes, fëmijët konsiderohen anëtarë aktivë dhe kontribues në familje, shoqëri dhe komunitetin ku ata jetojnë. Këto të drejta i referohen parimit të vetëvendosjes dhe konsiderohen të barasvlershme me të drejtat civile të të rriturve.

Ndjeshmëria në fëmijërinë e hershme është e hapur po ashtu ndaj konceptit të barazisë gjinore. Kjo është një periudhë vendimtare në të cilën fëmija zhvillon identitetin gjinor prandaj ekspozimi ndaj sjelljeve dhe qëndrimeve stereotipizuese duhet të shmangen.

Të qenit viktimë e pabarazisë apo dëshmitar/-e i/e saj mund të përvetësohet nga fëmija, dhe ai/a jo do ta riprodhojë këtë model më vonë (mekanizëm riprodhues). Për ta ndryshuar këtë dinamikë të pabarazisë gjinore, e cila është e dukshme (ashtu edhe e padukshme) në shumë aspekte, kurrikulat dhe përmbajtjet edukative kanë potencial të zbatojnë veprime që promovojnë respektimin e barazisë gjinore

nëpërmjet mjeteve edukative, edhe në rastet kur fëmija percepton ose përjeton pabarazi gjinore në mjedisin familjar. Për shembull, pabarazia gjinore mund të rezultojë kur edukatorët vlerësojnë një gjini specifike më shumë se tjetrën, ka vlerësim të lojërave të caktuara për një gjini të caktuar, ka ulje të qasjes për një gjini ose mbitheksim të njërës gjini, etj.

Përmbajtjet edukative nuk duhet t'i transmetojnë asnjë nga këto vlera për të siguruar gjithëpërfshirjen që i shërben zhvillimit të fëmijës. Duhet pasur kujdes të shtuar në përdorimin e materialeve e lodrave edukative të cilat nuk promovojnë stereotipe gjinore.

Zhvillimi demokratik në edukimin e hershëm i referohet një filozofie dhe qasjeje ndaj edukimit që thekson pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen aktive të fëmijës në moshë të hershme. Kjo qasje bazohet në demokraci, barazi dhe respekt për individin. Kjo është periudha në të cilën fëmija mund ta zhvillojë në një mënyrë demokratike konceptin se kush është, ta krijojë vlerën e nevojshme për demokracinë, si një parim udhëzues për pjesën tjetër të jetës.

Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme duhet të jenë një komunitet demokratik në të cilin të gjithë fëmijët kanë qasje dhe në të cilin ata mendojnë se mund të ndikojnë aktivisht në proceset e vendimmarrjes bazuar në kapacitetin dhe nivelin e tyre të përvojës.

Në një institucion demokratik të edukimit në fëmijërinë e hershme, fëmija inkurajohet t'i shpreh mendimet e tij\ saj, të bëjë zgjedhje dhe të marrë pjesë në menaxhimin e grupit të tij\ saj. Edukatorët veprojnë si lehtësues, duke i udhëhequr fëmijët teksa ata eksplorojnë,

eksperimentojnë dhe mësojnë përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera praktike. Kjo qasje pranon se fëmija është individ i aftë, kompetent dhe vlerëson kontributin e tij\ saj në komunitetin e të mësuarit. Institucionet demokratike të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme synojnë të krijojnë një mjedis pozitiv dhe mbështetës që zhvillon te fëmija ndjenjën për vetveten, respektin për të tjerët dhe aftësitë sociale dhe emocionale, duke i përgatitur ata për sukses në arsimimin e mëtejshëm dhe situata të ndryshme jetësore.

Të jesh një qytetar global, siç u tha, do të thotë të lidhesh me natyrën dhe me botën përreth. Në këtë kontekst, aftësitë motorike janë tejet të rëndësishme.

Zhvillimi motorik përfshin rritjen e koordinimit të muskujve dhe aftësive të lëvizjes tek fëmijët. Ky zhvillim përfshin aftësitë motorike të vogla, si të shkruarit ose puna me materiale të ricikluara, dhe aftësitë motorike të mëdha, si ecja ose kërcimi. Fëmijët fillojnë me reflekse të tilla si kapja ose thithja. Këto reflekse ngadalë bëhen veprime më të kontrolluara. Ndërsa fëmijët rriten, aftësitë e tyre motorike përmirësohen, duke i mundësuar ata të bëjnë gjëra si të hedhin një top ose të ngasin një biçikletë. Gjetet, rritja fizike dhe përvojat ndikojnë të gjitha në zhvillimin motorik. Fëmijët që luajnë aktivisht shpesh tregojnë koordinim të fortë dhe shkathtësi. Zhvillimi motorik i vonuar mund të tregojë probleme shëndetësore të fshehura. Veprimet e shpejta janë shumë të rëndësishme. Edukimi fizik dhe aktivitetet e lojës në IEFH mbështesin zhvillimin motorik të fëmijëve. Zhvillimi motorik ndryshon me rritjen e trupit të një personi dhe ambientet përreth.



### Vëmendje për edukatorët

Edukatorët prezantojnë vlera si empatia, respekti dhe përgjegjësia për t'i ndihmuar fëmijët të rriten si qytetarë globalë të sjellshëm. Aktivitetet si projektet e përbashkëta artistike ose detyrat e zgjidhjes së problemeve në grupe theksojnë punën në ekip dhe bashkëpunimin. Fëmijët mësojnë për qëllimet e përbashkëta përmes këtyre aktiviteteve. Kujdesi për mjedisin përfshin fëmijët në zakone të thjeshta të qëndrueshmërisë si riciklimi, kujdesi për bimët ose ulja e mbetjeve. Tregime, këngë dhe tradita kulturore nga vende të ndryshme i mësojnë fëmijët për diversitetin. Respektimi i ndryshimeve është i rëndësishëm. Fëmijët gjithashtu diskutojnë për drejtësinë dhe përfshirjen përmes shembujve të jetës reale ose lojës me role. Këto diskutime i ndihmojnë ata të mendojnë thellë për këto ide. Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimet e grupit tregon parimet demokratike. Kjo qasje i ndihmon fëmijët të ndjehen të vlerësuar dhe të krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë.



## Qëllimet për të nxënit për Kompetencën 5: Qytetaria Globale

### Grup-mosha 0-2 vjeç

- Fëmijët fillojnë të kuptojnë rrethin e tyre përmes eksplorimit me shqisat e tyre. Përvoja me pjesët natyrore dhe shoqërore të botës së tyre ndihmon fëmijët të mësojnë gjërat e para për jetën. Kjo zgjon kureshtjen dhe respektin për gjithçka që i rrethon ata.
- Ata/ato marrin pjesë në ndërveprime të thjeshta me prindërit/kujdestarët ligjorë, duke zhvilluar një ndjenjë përfshirjeje. Rutinat bazë si përhëndetjet u tregojnë fëmijëve themelet e ndërveprimeve shoqërore dhe respektit të ndërsjellë.
- Ata/ato shikojnë dhe imitojnë veprime në një mjedis grupor, si përhëndetja me dorë ose lamtumira. Ndjekja e veprimeve të grupit u mundëson fëmijëve të fillojnë të mësojnë normat shoqërore dhe identitetin e grupit.

### Grup-mosha 3-4 vjeç

- Fëmijët marrin pjesë në aktivitete grupore dhe mësojnë të ndajnë me bashkëmoshatarët. Ndihma në aktivitete u tregon fëmijëve rëndësinë e punës në grup. Këto aktivitete fillojnë të zhvillojnë të kuptuarit për atë se çfarë është e drejtë dhe cilat janë objektivat e përbashkëta.
- Ata/ato fillojnë të kuptojnë ide të thjeshta mbi mjedisin, si kujdesi për bimët ose riciklimi. Mësimi për qëndrueshmërinë që në fazat e hershme zhvillon një ndjenjë përgjegjësie për natyrën. Këto mësimë formojnë zakone për gjithë jetën.
- Ata/ato shmangin ose nuk kufizohen në lojëra stereotipike të bazuara në gjini.
- Ata/ato vërejnë dallimet te njerëzit dhe kulturat përmes historive dhe lojërave të ndryshme. Kuptimi i diversitetit u mëson empati dhe respekt për pikëpamje të ndryshme.

### Grup-mosha 5-6 vjeç

- Fëmijët ndihmojnë aktivisht me zgjedhjet e grupit në klasë ose këndet e lojës, siç janë zgjedhja e lojërave ose projekteve. Pjesëmarrja në aktivitetet e marrjes së vendimeve ndërton vetëbesim dhe jep një ndjenjë përgjegjësie. Fëmijët gjithashtu zbulojnë vlerën e veprimeve demokratike.
- Ata/ato kuptojnë konceptet themelore si drejtësia, barazia dhe kujdesi për mjedisin. Diskutimi për problemet globale ndihmon fëmijët të mendojnë thellë për vendin e tyre në tokë dhe mbështet sjellje të përgjegjshme.
- Ata/ato respektojnë dhe shijojnë diversitetin duke u bashkuar me tradita kulturore ose duke përdorur shumë gjuhë. Takimi me kultura të ndryshme zgjeron pikëpamjet e fëmijëve dhe krijon përfshirje. Ata shohin se diversiteti pasuron komunitetet.
- Ata/ato tregojnë ndjeshmëri gjinore dhe njëkohësisht pranojnë të luajnë midis djemve dhe vajzave për çdo temë.

# Kapitulli IV

Qasja pedagogjike  
dhe elementet në  
zbatim të kurrikulës





## 4. Qasja pedagogjike dhe elementet në zbatim të kurrikulës

### 4.1 Mjedisi i të nxënit

**M**jedisi i të nxënit në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme është thelbësor, siç janë edhe faktorë të tjerë si prindërit/kujdestarët ligjorë, edukatorët, bashkëmohatarët, menaxhmenti dhe stafi profesional e mbështetës i institucionit. Mjedisi i të nxënit adaptohet për të qenë në funksion të mësimnxënies dhe të mësimdhënies, dhe nënkupton më shumë sesa hapësirat fizike në të cilën qëndron fëmija. Është hapësira në të cilin fëmija rritet dhe zhvillohet. Për një fillim të mbarë, prindërit/kujdestarët ligjorë, edukatorët, menaxhmenti dhe stafi profesional e mbështetës, duhet të punojnë së bashku për të kaluar natyrshëm dhe gradualisht nga mjedisi i shtëpisë në mjedisin e Institucionit të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, ku fëmija ndjehet i sigurt dhe i gatshëm për të bashkëvepruar.

Ndërveprimi i fëmijës me mjedisin është gjithashtu i lidhur me ndërveprimin me të rriturit, bashkëmohatarët dhe rrethin social. Mjedisi në edukimin e hershëm konsiderohet edhe si “edukatori i tretë i fëmijës”.

Mjedisi duhet të jetë i dizajnuar në atë mënyrë që çdo fëmijë brenda grupit edukativ të luajë, eksplorojë, zbulojë gjëra të reja, të komunikojë dhe të zhvillojë marrëdhënie harmonike me bashkëmohatarët, të rriturit dhe mjedisin që e rrethon.

Mjedisi duhet të jetë i **përshtatshëm dhe i adaptueshëm**. Fëmija, shpesh, gjatë aktiviteteve argëtuese, edukative dhe eksplorimit ndjen nevojën për ta ndryshuar atë dhe për ta përshtatur me eksplorimet e tij\ saj. Ky adaptim krijon mundësi për të nxitur kuriozitetin dhe eksplorimin. Nëpërmjet pyetjeve, propozimeve dhe **dialogut aktiv**, edukatorët ndihmojnë fëmijët të realizojnë të drejtat e tyre e njëkohësisht ndërhyjnë në



mjedisi për të mundësuar arritjen e këtyre të drejtave.

Qëllimi i mjedisit të të nxënit është të krijojë situata që mundësojnë zhvillimin e plotë të fëmijës, duke krijuar mundësi kërkimore ku përvojat trajtohen si një tërësi, duke mos ofruar njohuri të fragmentuara. Mjedisi duhet gjithsesi të përfshijë mjete dhe materiale, veçanërisht **natyrore dhe të ricikluara, të strukturuar dhe të pastrukturuar**.

**Organizimi i mjedisit të të nxënit duhet t'i pasqyrojë idetë, vlerat, qëndrimet dhe kulturën e fëmijëve dhe stafit që jetojnë brenda tij**, në mënyrë që fëmija të mund t'i eksplorojë gjuhët e tij\ saj të ndryshme shprehëse.

**Mjediset e mëdha e të lira** inkurajojnë lëvizjen dhe aktivitetet me të gjithë grupin, ndërsa mjediset e vogla me mjete dhe materiale të ndryshme, krijojnë mundësi për lojë dhe ndërveprim me grupe më të vogla apo punë individuale, për gjurmime dhe eksperimentime me materialet dhe me mjetet e punës. Një mjedis i larmishëm nxitë, krijon përvoja dhe mundësi të ndryshme për zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.

**Mjedisi i jashtëm** i Institucionit të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (si parku, kopshti) duhet kuptuar si hapësirë e zgjeruar e mjedisit të brendshëm dhe përdorimi i saj është i shumëfishtë. Marrëdhënia me mjedisin e jashtëm është thelbësore, ku fëmija duhet të

qëndrojnë në këndin e lojërave jashtë dhe të jetë i/e lirë të zbulojë botën përreth tij\ saj. Kjo është e mirë për mendjen dhe trupin.

Efektet e përgjithshme pozitive shëndetësore të lojës së shpeshtë në natyrë me nivel të kontrolluar/menaxhuar të rrezikshmërisë, ofrojnë përfitime më të mëdha sesa efektet shëndetësore të shmangies së lojës në natyrë, përkundër rreziqeve të perceptuara. Loja në natyrë mbështet ndërveprimin social dhe ndihmon në kultivimin e të kuptuarit emocional.

Evidenca shkencore rekomandon qëndrimin e fëmijës në mjediset e jashtme të institucionit për rreth **1 orë brenda ditës, çdo ditë dhe në çdo stinë**, duke bërë përgatitjet e nevojshme në mjedis dhe veshmbathje. Kjo periudhë kohore, sikurse pjesa tjetër e ditës, duhet të jetë mirë e planifikuar.

Mjediset e jashtme dhe të brendshme të institucionit të edukimit në fëmijërinë e hershme zhvillojnë aftësitë njohëse, emocionale dhe psikomotorike të fëmijëve. Këto mjedise mund të ndryshojnë dhe të transformohen sipas nevojave zhvillimore të fëmijës; për shembull, shumë aktivitete mund të fillojnë në hapësirat e brendshme dhe të zhvendosen për t'u realizuar në mjediset e jashtme të institucionit. Në varësi të projektit dhe mënyrës se si e pasurojmë mjedisin, këto parime janë të aplikueshme për hapësira të ndryshme të IEFH-së.

Mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm duhet të mbështes zgjerimin e vazhdueshëm të njohurive të fëmijëve. Organizimi i mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit të EFH-së është elaboruar gjerësisht në udhëzuesin praktik për organizimin e hapësirave të të nxënës, që ndihmon zbatimin e Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.

## 4.2 Materialet

Në fëmijërinë e hershme, edukimi i qëndrueshëm është thelbësor dhe mund të arrihet duke i lejuar fëmijët të eksplorojnë mjedisin e tyre përmes lojës dhe veprimit të lirë.

Përmes aktiviteteve, lojës dhe eksplorimit, fëmijët bëhen të vetëdijshëm për një dukuri

ose koncept të ri, duke iu dhënë mundësinë të fitojnë njohuri të qëndrueshme. Për të zhvilluar këto kapacitete dhe për të realizuar aktivitete dhe eksplorime, materialet janë me rëndësi të veçantë. Diversiteti i materialeve është thelbësor. Për shembull, përmes lojës manipuluese, fëmijët mësojnë përmbajtje dhe zhvillojnë imagjinatën, kreativitetin, aftësitë motorike dhe shqisat në përgjithësi. Materialet natyrore janë të rëndësishme dhe përfshijnë gjëra të tilla si gurë, degë, gështenja, arra, lajthi, gjethe me madhësi dhe forma të ndryshme, etj. Këto materiale i lejojnë fëmijët të mësojnë rreth natyrës, të bëhen më të vëmendshëm, ta duan atë dhe të krijojnë një lidhje të fortë me të. Ndër të tjera, ato ndihmojnë fëmijët të mësojnë veçoritë e secilit produkt dhe material që takojnë. Materialet prej druri me forma të ndryshme mundësojnë manipulimin duke integruar fusha zhvillimi/kurrikulare dhe arrijtjen e kompetencave të përshtatshme për moshën. Materialet prej druri i lejojnë fëmijët të mësojnë përmes veprimit, lojës dhe eksplorimit të formave, madhësive, veçorive të objekteve, qëndrueshmërisë së materialit dhe karakteristikave të tjera.

Materialet e riciklueshme/ripërdorshme si shishet, kapakët, rulët, kutitë prej kartoni, kokrrizat, kopset dhe rrobat, ofrojnë një mundësi tjetër. Duke përdorur materiale të riciklueshme, fëmijët mësojnë për produktet, se si mund të ripërdoren dhe të mos hidhen, çfarë mund të ripërdoret dhe të përdoret për krijimin e gjërave për lojë, si dhe të shprehin imagjinatën dhe kreativitetin, ndërkohë që kontribuojnë në ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Është shumë e rëndësishme që materialet të prezantohen në mënyrë estetike. Estetika është



themelore për procesin e të mësuarit të fëmijëve dhe duhet të merret parasysh kur përgatitet hapësira për lojën dhe eksplorimin nga fëmija. Prezantimi i materialeve sipas ngjyrës, gjatësisë ose duke ndjekur një karakteristikë tjetër ndihmon procesin e të mësuarit të fëmijës dhe duhet të jetë një pjesë thelbësore e punës së edukatorit/es. Gjithashtu, prezantimi i materialeve bazuar në ide projektsh ose fusha kërkimi është shumë i rëndësishëm për proceset e të mësuarit.

### 4.3 Roli i edukatorit/es

Në fëmijerine e hershme, **roli i të rriturit** transformohet nga edukator në bashkëkrijues dhe **bashkëstudiuës** me fëmijën dhe mbështesin **procesin edukativ të vazhdueshëm**. Fëmijët bartin me vete shumë mendime, ide, dhe kuriozitet, të cilat shprehen përmes pyetjeve të shumta por edhe teorive apo interpretimeve imagjinative të dukurive të ndryshme. Kjo është shumë e rëndësishme për të theksuar rolin qendror që fëmija ka në zhvillimin e proceseve njohëse, të kuptuarit, dhe krijimit të mendimeve.

**Të dëgjuarit** duhet të kuptohet si proces që nënkupton përqendrim të plotë në gjendjen dhe aktivitetin e fëmijëve. Ai nënkupton dëgjimin apo të kuptuarit e formave të ndryshme shprehëse të fëmijës, quajtur ndryshe “gjuhët e fëmijës” dhe **NUK** nënkupton vetëm regjistrim por interpretim të fjalëve apo mesazheve të fëmijës apo bashkëbisedim me fëmijën.

Një nga detyrat parësore të edukatorëve është të mbështesin fëmijën në procesin e të nxënimit duke u bazuar në nevojat dhe



shkathtësitë e fëmijëve dhe me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të procesit njohës dhe zgjerimit të njohurive të fëmijëve.

Të kuptuarit e proceseve njohëse të fëmijëve dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me fëmijët është i rëndësishëm pasi përfaqëson mënyrën se si edukatori/-ja mbështet njohuritë e fëmijës. Vëzhgimet e detajuara, reflektimet mbi interesat, nevojat, sfidat që fëmijët hasin arrihen përmes **vëmendjes së ndjeshme** dhe perkushtimit të edukatoreve. Kur edukatori/-ja vëzhgon fëmijën gjatë proceseve të tyre të të nxënimit, i dëgjon dhe u kushton vëmendje veprimeve të tyre, ai\ajo kupton përmes dëgjimit, intuitës, dhe deklaratave të qarta të fëmijës. Në këtë mënyrë, edukatori/ja identifikon edhe fushat e veçanta që duhet të analizohen më shumë. Është thelbësore të përpiqemi t'i identifikojmë, t'i ruajmë, dhe vëzhgojmë interesat e fëmijëve sepse ato shpesh përfaqësojnë fusha të reja që hapen ndaj njohurive të tjera.

Edukatori/-ja duhet t'i përkthejë veprimet e fëmijës në një analizë përmbledhëse që paraqitet si një reflektim i ri për t'u sjellë në vëmendjen e fëmijës përmes aktiviteteve të planifikuara qëllimisht nga edukatori/ja. Në këtë mënyrë, ai\ajo do t'i avancojë teoritë e tij\ saj të mëparshme, duke ndërtuar teori të reja dhe më të përpunuara.

Përditësimi i planeve të aktiviteteve bazuar në vëzhgimin e fëmijëve favorizon evolucionin e projekteve edukative, dhe kjo i mundëson fëmijës të shtrihet brenda horizonteve të ndryshme të dijes pa e ndalur kurrë kureshtjen e tij\ saj, dëshirën për të eksperimentuar dhe për ta njohur botën.

Puna me këtë qasje do të thotë që njohuritë kurrikulare preken në mënyrë tërthore dhe të ndërlidhur në vend që të jenë të ndara nga të tjerat.

Edukatori/-ja **vepron si lehtësues** dhe krijon për fëmijënjëmjedistësigurt, nxitës, të bazuar në lojë, ku fëmija mund të eksperimentojë dhe të eksplorojë ambientin përreth dhe më gjerë. **Mjedisi miqësor, i sigurt dhe i besueshëm** i krijuar nga edukatori/ja është një element kyç për zhvillimin e fëmijës, pasi krijon kushte që ndihmojnë mirërritjen dhe të nxënimit në mënyrë të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Mjedisi miqësor është një vend ku fëmijët

ndihen të mirëpritur dhe të pranuar duke krijuar një lidhje pozitive me edukatorin dhe bashkëmohatarët dhe shprehin mendimet, ndjenjat dhe idetë e tyre pa pasur frikë nga gjykimi. Kjo inkurajon zhvillimin e vetëbesimit dhe të menduarit kritik. **Mjedisi i sigurt** është një element themelor për çdo fëmijë. Kjo përfshin jo vetëm sigurinë fizike, si mjediset e pastra dhe të mbrojtura, por edhe sigurinë emocionale, si dhe **ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar stresin**. Fëmijët në një mjedis të sigurt janë më të aftë të përballen me sfida dhe të merren me emocionet e tyre. Edukatori/ja **nxit** ndjenjë të komunitetit në grup, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës ku fëmijët mund të mësojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin. **Mjedisi i besueshëm si dhe krijimi i një lidhjeje besimi mes edukatorit/ës dhe fëmijës** është një hap i rëndësishëm për të krijuar një mjedis ku fëmijët rriten dhe të zhvillohen. Besueshmëria krijohet gjithashtu kur rregullat dhe pritshmëritë janë të qarta dhe të drejta. Fëmijët ndjehen më të sigurt dhe të besueshëm kur kanë mundësinë të kuptojnë se si do të trajtohen dhe çfarë pritet nga ata. Në këtë mënyrë, edukatori/ja **modelon** vlera si respekti, barazia, bashkëpunimi dhe ndjeshmëria në ndërveprimet e tyre me fëmijët dhe synon bartjen e vlerave tek ata. Edukatorët/et sigurojnë **gjithpërfshirje hartuar** plane pedagogjike me fëmijën në qendër, bazuar në zhvillimin individual, mundësitë, nevojat dhe interesat e fëmijëve. Ai/ajo përzgjedh dhe siguron materiale të ndryshme për realizimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve të planifikuara. **Identifikon dhe raporton** çështjet që mund të shfaqen gjatë aktiviteteve që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës. **Dokumenton** përmes formave të ndryshme procesin e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve. **Angazhohet** në mësim të vazhdueshëm dhe reflektim mbi praktikën e tyre, duke qëndruar e përditësuar me kërkimet më të fundit dhe praktikën më të mira për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe ndikimin e saj/tij në zhvillimin e fëmijëve. **Bashkëpunon me aktivin dhe stafin profesional** (edukatorët, psikologu, pedagogu, logopedi etj.) brenda dhe jashtë institucionit për të shkëmbyer përvojat

e mira, sfidat dhe vështirësitë që has në praktikën e saj/tij të përditshme.

**Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët ligjorë** gjatë planifikimit dhe realizimit të planit të punës, duke i bërë ata pjesë të përditshmërisë të punës edukative për të siguruar mirëqenien, edukimin, mirërritjen, dhe zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve.

#### 4.4 Mjetet e planifikimit

Është thelbësore të përcaktojmë qasjen ndaj organizimit të punës edukative, si dhe zhvillimin e kurrikulës në praktikë.

Për të zhvilluar kompetencat e kurrikulës dhe për ta bërë të dukshëm procesin e të nxënimit të fëmijëve, është e domosdoshme të veprohet dhe të reflektohet përmes mjeteve të planifikimit, të cilat, nga njëra anë, mbështesin hartimin e aktiviteteve, strukturojnë punën, gjenerojnë ide, dyshime dhe fusha për punë të mëtejshme edukative, dhe nga ana tjetër, mund të ndërtojnë platformën konceptuale që mbështet dokumentimin e proceseve të zbatuara me dhe nga fëmijët.

Mjetet e planifikimit përfaqësojnë një nga elementet e punës që janë në dispozicion të edukatorit/ës; ato i përgjigjen nevojës për të përshkruar dhe projektuar aktivitete kurrikulare dhe mundësojnë përshkrimin e proceseve të të nxënimit të fëmijëve përmes gjuhës së shkruar.

Përdorimi i instrumenteve të tilla e bën kurrikulën e edukimit në fëmijërinë e hershme të zbatueshme. Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (EFH) duhet të krijojnë identitetin e tyre institucional, të mbështesin filozofitë e EFH-së dhe të zgjedhin qasje metodologjike që shoqërojnë proceset e vazhdueshme të planifikimit dhe zbatimit të tij. Ato duhet të bazohen domosdoshmërisht në parimet dhe kompetencat e kësaj Kurrikule dhe të jenë në përputhje me legjisllacionin në fuqi që mbështet zhvillimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë.

**Planet e punës** janë tipologji që përfaqësojnë një formë dokumentimi për institucionet e EFH-së. Këto përfshijnë planin vjetor (i konceptuar si udhëzues), i cili përfaqëson një mjet pune që bën të qarta idetë, qëllimet, mundësitë dhe

dukshmërinë e tyre. Ai përshkruan objektivat e institucioneve të EFH-së, identifikon strategjitë, mjetet, teoritë dhe proceset e mundshme edukative dhe të tjera që integrohen brenda institucioneve të EFH-së. Ai prezanton punën dhe jetën e përditshme që ndodhe brenda institucionit të EFH-së.

**Plani vjetor** mund të shërbejë gjithashtu si një mundësi reflektimi dhe studimi të vazhdueshëm me projekte të zbatuara më parë. Ai mbështet vlerën e punës me fëmijën, marrëdhëniet midis edukatorëve dhe mendimet e përgjithshme për projektet edukative. Përmbajtja e planit gjenerohet duke dëgjuar fëmijën (interesat dhe kureshtjet e tyre), edukatoren ose nga interesat e prindërve/kujdestarëve ligjorë apo të komunitetit.

Plani vjetor i punës duhet të konsiderohet si një udhëzues për planet mujore dhe javore, por nuk është i pandryshueshëm. Ai mund të përshtatet në varësi të interesave dhe nevojave njohëse të fëmijës, prindërve/kujdestarëve ligjorë, komunitetit apo rrethanave të tjera të jashtme. Plani vjetor duhet të jetë i dukshëm dhe i ekspozuar brenda mjediseve të dukshme të institucioneve të EFH-së. Ky dokument shërben si një mjet pune për stafin edukativ, por njëkohësisht duhet të shërbejë si udhëzues për bashkëpunëtorë të tjerë profesionalë (si pedagogu, psikologu, logopedi, inspektori, etj.).

**Planet mujore** përfaqësojnë përcaktimin e fushave tematike që synohen të punohen gjatë muajit. Edukatori/ja planifikon së bashku me fëmijën, bazuar në interesat dhe nevojat e tij. Në fund të muajit, edukatorët rishikojnë dhe interpretojnë vëzhgimet për të reflektuar mbi konceptet që do të trajtohen muajin pasues. Plani mujor ka për qëllim ta bëjë të dukshëm dhe të lexueshëm procesin e përparimit kurrikular dhe të ridefinojë skenarin e punës për të ardhmen.

**Planet javore** specifikojnë veprimet edukative që rrjedhin nga planifikimi mujor. Përveç përcaktimeve të përmbajtjes së temës apo projektit zhvillimor, planet javore përfshijnë përcaktimin e mënyrës së strukturimit të punës brenda hapësirës edukative me pjesëmarrjen e fëmijës, edukatorit dhe familjes.

Mjetet e vëzhgimit janë thelbësore për të kuptuar proceset e të nxënies të fëmijës,

interesat dhe çështjet e ndjeshme që duhet të eksplorojnë gjatë projektit dhe përfaqësojnë bazën mbi të cilën mund të mbështetet reflektimi mbi njohjen dhe rinisjen e projekteve dhe proceseve të planifikimit. Vëzhgimi i asaj që bën fëmija, përfshirë veprimet, gjestet, ndërhyrjet dhe mendimet e shprehura, është vendimtar në çdo planifikim dhe zbatim të kurrikulës.

**Plani ditor:** Nuk është saktësisht një mjet planifikimi dhe i referohet përmbajtjes së rutinës ditore, të parashikueshme për fëmijët, mbështetur në planin javor. Është një formë dokumentimi që regjistron punën me fëmijën dhe jetën e përditshme. Është thelbësore që të përdoret gjuhë e kuptueshme dhe e qasshme për të gjithë, pasi është një nga format më të përdorura, më të ndryshueshme dhe më të arritshme për prindin/kujdestarin ligjor. Ditari apo fletorja e dokumentimit nuk duhet të jetë reduktiv, i thjeshtëzuar ose thjesht kronologjik në mënyrën e tij narrative. Për këtë arsye, është e rëndësishme që jeta e përditshme në institucionet e EFH-së të nënkuptohet dhe të vlerësohet, duke ia rikthyer vazhdimisht prindit në vëmendje potencialin e fëmijës, në mënyrë që të përcillet një imazh i fortë i fëmijës drejt një kulture të përbashkët për fëmijërinë.

## 4.5 Organizimi i kohës

Organizimi i kohës ditore në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH), lidhet me nevojën për të krijuar harmoni midis kohës dhe ritmit të fëmijëve dhe atyre të institucionit. Këto dy “ritme” shpesh nuk janë të balancuara mirë, dhe institucioni duhet të ketë kapacitetin për të gjetur një kohë harmonike në respekt të të drejtave të fëmijëve pa prishur organizimin. Për këtë kërkohet një nivel i lartë bashkëpunimi.

Orari ditor duhet të ketë një strukturë të qëndrueshme që i lejon fëmijës të gjejë pika të qëndrueshme referimi dhe të përshtatet me një kontekst kohor të dallueshëm, të kuptueshëm (për fëmijën) dhe të parashikueshëm. Kujdesi ndaj kohës duhet të shtrihet edhe në kalimet nga një aktivitet në tjetrin, duke u siguruar që kjo të jetë në përputhje me qëllimet e kurrikulës. Të gjitha këto duhet të merren parasysh në planifikimin e organizimit të programit edukativ.

## Disa arsye pse rutinat e përditshme janë të rëndësishme në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (EFH) përfshijnë:

**Krijimi i një ndjenje stabiliteti:** Një fëmijë në fëmijërinë e hershme zhvillohet më mirë në mjedise ku ndihet i/e sigurt dhe i/e mbrojtur. Rutinat ditore krijojnë një orar të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm, që ndihmon fëmijën të ndihet më rehat dhe i/e sigurt, sepse të diturit çfarë të presë në kohë të ndryshme të ditës zvogëlon ankthin dhe ofron një ndjenje stabiliteti.

**Promovimi i vetërregullimit dhe pavarësisë:** Rutinat ditore ofrojnë mundësi për fëmijën që të zhvillojë aftësi për vetërregullim. Duke ndjekur një rutinë të strukturuar, fëmija mëson të menaxhojë kohën e saj/tij, të kalojë nga një aktivitet në tjetrin dhe të rregullojë sjelljen e saj/tij. Rutinat e qëndrueshme gjithashtu nxisin pavarësinë, pasi fëmija bëhet i familjarizuar me pritshmëritë dhe fuqizohet të angazhohet në aktivitete vetë.

**Mbështetja e zhvillimit social dhe emocional:** Rutinat ofrojnë mundësi për ndërveprime sociale dhe zhvillim emocional. Gjatë rutinave si takimet e mëngjesit, kohës së ngrënies ose lojës në natyrë, fëmija mëson të respektojë radhën, të ndajë gjëra, të bashkëpunojë dhe të komunikojë me bashkëmoshatarët. Rutinat gjithashtu ofrojnë momente që edukatori/ja të modelojë dhe të forcojë sjelljet sociale pozitive, empatinë dhe rregullimin emocional.

**Mbështetja e zhvillimit kognitiv:** Rutinat ofrojnë mundësi për zhvillim kognitiv përmes përsëritjes, ripërsëritjes dhe përforcimit. Një strukturë e përditshme ndihmon fëmijën të mësojë dhe të përbrendësojë (internalizojë) koncepte si radhitja, konceptet kohore dhe marrëdhëniet shkak-pasojë. Për shembull, një aktivitet mëngjesi që ndjek një sekuencë specifike (p.sh., ardhja, përshëndetjet, takimi i mëngjesit) ndihmon fëmijën të kuptojë dhe të parashikojë rrjedhën e ngjarjeve. Një ndarje e arsyeshme e kohës për reflektim i mundëson fëmijës të marrë kohën e nevojshme për të

përpunuar dhe për t'u familjarizuar me koncepte të lehta dhe komplekse, dhe t'i konsolidojë ato përmes eksplorimit, kërkimit dhe përshtatjes së vazhdueshme. Në këtë drejtim, aktivitetet kurrikulare duhet gjithmonë të caktojnë një kohë që fëmijët të reflektojnë mbi përvojat pas çdo eksperience.

**Inkurajimi i ndjenjës së përgjegjësisë:** Një rrjedhë harmonike ditore ndihmon fëmijët të zhvillojnë një ndjenje përgjegjësie ndërsa mësojnë të marrin pjesë në aktivitete dhe të kujdesen për interesat e tyre personale. Aktivitetet si rregullimi ose pastrimi pas lojës, larja e duarve para ngrënies, ose paketimi i gjërave personale kultivojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe pronësisë. Kjo mbështet zhvillimin e aftësive jetësore esenciale dhe promovon një ndjenje përkatësie brenda klasës ose komunitetit të grupit.

**Mbështetja e aftësive të gjuhës dhe komunikimit:** Rrjedha ditore ofron një kontekst për zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit. Përmes aktiviteteve të përditshme, fëmija angazhohet në biseda, ndjek udhëzime dhe merr pjesë në ndërveprime domethënëse me edukatorin dhe bashkëmoshatarët. Rrjedha ditore krijon një platformë për zhvillimin e fjalorit, modelimin e gjuhës dhe përforcimin e aftësive të komunikimit.

**Inkurajimi i zakoneve të shëndetshme:** Orari ditë shpesh përfshin aktivitete që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien. Këto mund të përfshijnë larjen e rregullt të duarve, larjen e dhëmbëve, zakone të ushqyerjes së shëndetshme, ushtrime fizike dhe pushime ose kohë për gjumë. Praktikimi i vazhdueshëm i këtyre rutinave ndihmon fëmijën të zhvillojë zakone të shëndetshme që kontribuojnë në mirëqenien e tij të përgjithshme.

**Ndërtimi i ndjenjës së rregullit dhe koncepteve kohore:** Rutinat ndihmojnë fëmijën të kuptojë konceptet e kohës, rregullit dhe renditjes. Duke përjetuar rutinat e përditshme, fëmija mëson të njohë rendin e ngjarjeve dhe të kuptojë kalimin e kohës (p.sh., mëngjes, pasdite, mbrëmje). Ky kuptim themelor kontribuon në zhvillimin e tij kognitiv dhe aftësinë për

të organizuar mendimet dhe veprimet e tij.

### **Përmirësimi i gatishmërisë për të**

**mësuar:** Rutinat ditore krijojnë një mjedis që mbështet gatishmërinë për të mësuar. Kur fëmija di çfarë të presë dhe ndihet i sigurt në rrjedhën e tij ditore, ai është më i hapur ndaj përvojave edukative. Një rutinë e strukturuar lejon një kombinim të balancuar të angazhimit aktiv, pushimit dhe mësimi të fokusuar, duke optimizuar gatishmërinë dhe motivimin e fëmijës për t'u angazhuar në aktivitete edukative.

### **Forcimi i menaxhimit të klasës/grupit:**

Struktura ditore shërben si bazë për menaxhimin efektiv të klasës ose grupit. Një rutinë e mirëstrukturuar ndihmon edukatorët të menaxhojnë kalimet në mënyrë të qetë, të ruajnë rendin dhe të shpërndajnë kohën në mënyrë efektive. Kjo minimizon ndërprerjet, redukton sjelljet sfiduese dhe krijon një mjedis pozitiv edukativ si për edukatorët, ashtu edhe për fëmijët.

Në përgjithësi, rutinat ditore ofrojnë përfitime të shumta në edukimin në fëmijërinë e hershme, duke kontribuar në mirëqenien emocionale, zhvillimin shoqëror, rritjen njohëse dhe gatishmërinë për të mësuar të fëmijës. Duke krijuar një strukturë kohe të qëndrueshme dhe mbështetëse, edukatorët krijojnë një mjedis optimal për zhvillimin holistik (tërësor) të fëmijëve të vegjël.

### **Institucionet e EFH-së dhe rutinat e**

**shkruara:** Institucionet e EFH-së duhet të kenë rutina të shkruara të përshtatura për grupmosha të ndryshme dhe për formën e ofrimit të shërbimeve të EFH-së, të harmonizuara me objektivat e përmendura më parë. Disa nga elementët thelbësorë të rutinave ditore mund të

gjenden në “Udhëzuesin Praktik për Mbështetjen e Zbatimit të Kurrikulës së EFH-së,” së bashku me modele të dhëna për grupmosha të ndryshme.

### **Maksimizimi i vlerës së kohës në**

**institucion:** Koha që fëmijët kalojnë në një institucion është e çmuar, dhe mënyra se si edukatori/ja e shfrytëzon atë ka rëndësi të madhe. Prandaj, aktivitetet duhet të planifikohen në mënyrë efektive. Meqenëse qëllimi kryesor është ndjekja e interesave, kuriozitetit dhe trajektores kulturore të fëmijës, edukatori/ja duhet të jetë i përgatitur paraprakisht (me kontekste, shembuj, stimuj). Për më tepër, ai/ajo duhet ta përdorë kohën për të analizuar atë që fëmija propozon, përpunon dhe krijon.

Për këtë arsye, mjetet e planifikimit janë themelore dhe edukatorët duhet të mësojnë t'i përdorin ato në aktivitetet e tyre të përditshme, në vend që t'i përpilojnë ato periodikisht. Praktika e arsyeshme dhe e thjeshtë e mjeteve të vëzhgimit ditor, planifikimit javor dhe mujor, dhe një dokument gjithëpërfshirës vjetor për qëllimin edukativ është kritikisht e rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve edukative.

Kur përdoren si duhet, këto mjete mund të kapin në mënyrë efektive proceset e fëmijës dhe të parashikojnë zhvillimin e mundshëm ose t'i sugjerojnë ide të reja fëmijës për një analizë të thelluar të fenomeneve të ndryshme. Nëse përdoren keq, mund të duken si një humbje kohe. Në fakt, ato janë jashtëzakonisht të vlefshme nëse mbahen të thjeshta dhe të afta për të kapur procese të rëndësishme.

## 4.6 Dialogu edukator/e-fëmijë

Edukatori/-ja duhet ta trajtojë fëmijën me korrektësinë më të madhe, duke vlerësuar sjelljen e tij\ saj kur është e mundur ose duke udhëzuar fëmijën për mënyrën më të mirë të krijimit të marrëdhënieve shoqërore. Në çdo rast duhet shmangur çdo lloj i dhunës verbale dhe joverable, të cilat janë **të ndaluara** dhe thellësisht të dëmshme për zhvillimin e fëmijës.

### Biseda me fëmijët dhe pyetjet e hapura

Çdo pyetje që bën fëmija është një kërkim për të zbuluar njohuri të vazhdueshme dhe njohëse. Çdo pyetje që bën një i rritur duhet të nxisë kuriozitetin dhe hulumtimin tek fëmija. Kjo arrihet përmes pyetjeve të drejtpërdrejta (por të hapura) dhe duke paraqitur një kontekst.

Pyetjet nxisin mendimet dhe e bëjnë procesin e hulumtimit më të qasshëm dhe më të lidhur. Në këtë kuptim, edukatori/-ja duhet të jetë i/e aftë të lexojë edhe mënyrat e mundshme, duke e lënë gjithmonë fëmijën të lirë të ndërtojë mënyrën e tij\ saj të të nxënit.

Në fund të fundit, këto pyetje shërbejnë edhe për të kuptuar se çfarë mendon fëmija për një çështje, si dhe për të nxitur mendime të reja dhe për t'i mbledhur mendimet e tij\ saj të cilat duhet të bëhen në planifikim nga stafi edukativ.

Pyetjet që i bëhen fëmijës quhen pyetje të përgjithshme ose pyetje të hapura. Ato ndahen në tri lloje:

- Reflektuese,
- Qarkore/rrethore
- Strategjike.

Për më tepër, ju lutem shihni “Udhëzuesin praktik që ndihmon zbatimin e Kurrikulës së EFH-së”.

Gjatë bisedës, është e rëndësishme që të gjithë fëmijët të lejohen të marrin pjesë. Në të njëjtën kohë nuk duhet të detyrohet fëmija, dhe duke qenë kështu duhet të respektohet heshtja ose mënyra e ndryshme individuale e pjesëmarrjes së secilit fëmijë.



Biseda duhet të jetë sa më e natyrshme në mënyrë që fëmija ta përjetojë këtë moment sa më mirë, si një mundësi për t'u zhvilluar, por edhe për të mësuar për punën në grup, veçanërisht nga këndvështrimi kolektiv. Për këtë arsye, është thelbësore të krijohen situata të dialogut edhe në grupe të vogla. Në çdo rast, qasja pyetje-përgjigje duhet të shmanget (ku edukatorët bëjnë pyetje të shumta dhe fëmija detyrohet të përgjigjet).

Mënyrat e reflektimit, në fakt, lindin në grupe të mëdha, por është pikërisht puna në grupe të vogla ajo që krijon mundësi për t'u thelluar në një çështje dhe për t'u dhënë fjalën atyre që janë më të ndruajtur ose më pak komunikues.

Për të debatuar dhe për të huazuar koncepte dhe njohuri nga njëri-tjetri, edukatori/-ja krijon grupe më të vogla të fëmijëve për t'u dhënë atyre më shumë kohë për të hulumtuar dhe për të menduar.

## 4.7 Gjithëpërfshirja dhe qasja gjithëpërfshirëse

Përfshirja e fëmijës është një e drejtë e artikuluar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe gjithashtu është një nga vlerat e përgjithshme të Kushtetutës së Kosovës. Promovimi i përfshirjes në edukimin në fëmijërinë e hershme nënkupton vlerësimin dhe respektimin e diversitetit të të gjithë fëmijëve dhe krijimin e një mjedisi edukativ gjithëpërfshirës që është mikpritës dhe mbështetës për të gjithë, pa dallim. Kjo nënkupton që përmbajtjet programore, planet (planet javore dhe mujore si dhe plani individuale arsimor (PIA), strategjitë dhe mjedisi edukativ të mbështes = nevojat

individuale në mënyrë që secili fëmijë të zhvilloj maksimalisht potencialin e saj/tij.

Institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme duhet të krijojnë mjedise mikpritëse për të gjithë fëmijët që të përjetojnë përvojën më të mirë të mundshme të edukimit. Gjithëpërfshirja nënkupton përfshirjen e të gjitha dallimeve që bartin fëmijët. Do të thotë krijimi i mundësive për çdo fëmijë (dhe familjet e tyre) për t'u zhvilluar, duke ndihmuar atë që të jetë protagonist i procesit **edukativ**. Është obligative të përdoret gjuhë gjithëpërfshirëse pa paragjykitime apo stereotipe, duke shmangur përdorimin e përemrave specifike të gjinisë ose të bërit e supozimeve për aftësinë e fëmijës bazuar në pamjen ose prejardhjen e tij\ saj.

**Ndërtimi i marrëdhënieve me familjet** është i rëndësishëm për të mësuar rreth vlerave, besimeve dhe traditave të tyre. Edukatori/-ja duhet të sigurohet që familjet ndjehen të mirëpritura në grup dhe inkurajojnë ato të marrin pjesë në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme.

**Strategjitë e ndryshme** të të nxëniet që u përgjigjen aftësive të ndryshme të të nxëniet e ndihmojnë fëmijën që lehtësisht të ndihet pjesë e një sistemi grupi\klase. Synimi i përgjithshëm është mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes punës me prindërit, stafin profesional dhe specialistët për të zhvilluar dhe zbatuar plane individuale për fëmijën me aftësi të kufizuara. Edukatori/-ja duhet të sigurojë mbështetjen e nevojshme për t'i ndihmuar të gjithë fëmijët të marrin pjesë plotësisht në aktivitetet në klasë\grup.

Institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme duhet të shohin fëmijët si pjesë të integruar dhe të natyrshme të punës së tyre gjatë edukimit në fëmijërinë e hershme. Mbështetja dhe angazhimi i stafit edukativ, profesional, menaxherial, administrativ, dhe anëtarëve të komunitetit, janë thelbësore për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe edukimin në grup për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga dallimet. Për t'u bërë faktorë të ndryshimit dhe nxitës të përfshirjes sociale, edukatori/-ja duhet të zhvillojë kapacitetet e institucionit të tij\ saj për të punuar me grupe të ndryshme të fëmijëve, për të siguruar pjesëmarrjen dhe për të mbështetur zhvillimin dhe të nxëniet.



Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm është një qasje shumëdimensionale që synon të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, duke siguruar që ata të ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin e tyre. Kjo fillon me njohjen e veçantive të çdo fëmije, duke vlerësuar aftësitë e tyre të ndryshme, prejardhjet kulturore dhe stilet e të nxëniet. Edukimi gjithëpërfshirës siguron që çdo fëmijë, pavarësisht nga aftësitë e tij, të ketë qasje në përvoja cilësore të të nxëniet në mjedise që përqafojnë diversitetin dhe nxisin pjesëmarrjen.

Ajo/ai ndërton një ndjenjë përkatësie duke krijuar një mjedis ku fëmijët ndihen të pranuar dhe të respektuar, duke forcuar vetëbesimin dhe duke inkurajuar ndërveprime pozitive me bashkëmoshatarët dhe edukatorët/et. Përfshirja nuk ka të bëjë vetëm me praninë fizike në një grup\klasë, por edhe me pjesëmarrjen kuptimplotë në të gjitha aktivitetet, duke siguruar që fëmijët të jenë kontribues aktivë në udhëtimin e tyre të të nxëniet.

Edukatorët kanë një rol vendimtar në gjithëpërfshirje, pasi ato duhet të përshtatin metodat e edukimit për të përmbushur nevojat individuale, duke përdorur strategji që mbështesin stilet e ndryshme të të nxëniet,

ndërkohë që mbajnë pritshmëri të larta për të gjithë fëmijët. Edukimi gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme i jep përparësi bashkëpunimit me familjet/kujdestarët ligjorë, duke i njohur ata si partnerë kyç në procesin e të nxënit dhe duke vlerësuar njohuritë dhe kontributet e tyre.

Zhvillimi profesional është thelbësor për edukatorët që të fitojnë aftësi dhe njohuri të nevojshme për të krijuar grupe përfshirëse, duke i pajisur ata për të trajtuar sfidat dhe për të zbatuar praktikën më të mirë në mënyrë efektive. Përfshirja gjithashtu thekson rëndësinë e kultivimit të marrëdhënieve mes bashkëmoshatarëve, duke u mësuar fëmijëve empatinë, bashkëpunimin dhe respektin për ndryshimet që në moshë të hershme.

Mjediset e edukimit të qashtëm janë një tjetër shtyllë e përfshirjes, me hapësira fizike, materiale dhe burime të dizajnuara për të përmbushur nevojat e të gjithë fëmijëve, përfshirë ata me aftësi të kufizuara. Më në fund, gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm mbështetet nga politika dhe praktika që avokojnë për barazi dhe përfshirje në çdo nivel, duke siguruar një angazhim sistematik për të ofruar mundësi që të gjithë fëmijët të zhvillohen.

Përmes këtyre parimeve, gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm bëhet një kornizë e fuqishme për të ushqyer një shoqëri më të drejtë dhe më empatike.

## 4.8 Pjesëmarrja e familjes

Dialogu me familjet është një element thelbësor i procesit edukativ të institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe, në përgjithësi, i kulturës së edukimit në këtë periudhë. Familjet janë pjesë e aktiviteteve edukative dhe duhet të marrin dhe të ruajnë një rol të fuqishëm edhe në edukimin e hershëm të fëmijëve të tyre.

Familjet inkurajohen të marrin pjesë përmes dialogut dhe shkëmbimit të ideve dhe burimeve, prandaj, institucioni edukativ duhet të jetë një vend i ndryshimit kolektiv dhe komunikimit mes individëve në një sistem shoqëror. Ky është një mjedis që mirëpret individë të ndryshëm që veprojnë së bashku dhe ndajnë një rrugëtim të rritjes individuale



dhe kolektive: fëmijët, edukatorët dhe prindërit.

Institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme, si hapësira edukative, duhet të bazohen në përgjegjësinë e përbashkët në edukimin e fëmijës, duke njohur rolin aktiv dhe të përgjegjshëm të çdo familjeje në edukimin e fëmijës së saj. Udhëtimi edukativ fillon me familjen përmes procesit të njohjes. Të njohësh prindin si një “ekspert” për fëmijën e tij, veçanërisht në periudhën fillestare të frekuentimit të institucionit në fëmijërinë e hershme, do të thotë të vlerësosh rolin e saj/tij në shoqërim dhe sigurim, si dhe kalimin gradual nga bota kognitivo-emocionale e fëmijës brenda familjes drejt zhvillimit të marrëdhënieve të tjera që formohen brenda institucionit edukativ.

Kjo do të thotë të sigurohet një hapësirë që nxit kontributin e prindërve/kujdestarëve ligjorë të fëmijëve, të cilët bashkëpunojnë me IEFH dhe stafin edukativ duke krijuar një komunitet rreth fëmijës dhe ku pjesëmarrësit gjejnë kuptim dhe qëllim në pjesëmarrje. Të flasësh për pjesëmarrjen prindërore, nga kjo perspektivë, do të thotë t’i kërkojë prindit të jetë “pjesë” në procesin edukativ brenda institucionit. Kjo kërkesë lidhet me “veprimin” në një “pjesë” të procesit dhe rrugëtimin

edukativ, duke sjellë atë që njerëzit—vajza/djem, gra/burra, nëna/baballarë, kujdestarë ligjorë, gjyshër, qytetarë — besojnë se mund të kontribuojnë në kontekstin e edukimit në fëmijërinë e hershme.

Ndarja dhe ndërtimi i përvojës edukative me prindin\kujdestarin ligjor, me edukatorin, por mbi të gjitha me vetveten dhe me fëmijët e tjerë, gjithashtu nënkupton sjelljen e perspektivës së tyre në një mjedis që vlerëson dhe dëgjon dallimet.

Kjo kërkon nga të gjithë dëgjimin dhe të kuptuarit e saktë të perspektivës së tjetrit dhe konsiderimin e perspektivave të ndryshme si pasurim i diskutimeve dhe ideve, dhe jo si një kufizim. Në këtë mënyrë, angazhimi i prindërve/kujdestarëve ligjorë është një formë e marrjes së një roli shumë aktiv në jetesën në IEFH, me shumë përgjegjësi sepse angazhimi me çështjen e edukimit në fëmijërinë e hershme do të thotë të marrësh përgjegjësinë për të ardhmen dhe interesat e komunitetit.

Pjesëmarrja në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme shpreh konceptin e demokracisë si një mënyrë jetese, mendimi, imagjinatë dhe si një akt që projekton të ardhmen.

Prindërimi evoluon vazhdimisht gjatë rrugëtimit të fëmijëve në institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe përtej tij. Detyra e edukatorit\es, është gjithashtu të inkurajojë lloje të ndryshme të pjesëmarrjes, në të cilat çdo familje mund të identifikojë mënyrat më të përshtatshme të bashkëpunimit. Prandaj, pas momenteve fillestare të njohjes së ndërsjellë mes fëmijëve, prindërve\kujdestarëve ligjorë dhe IEFH-së, është e dobishme të identifikohen mënyra ndërveprimi që marrin forma të ndryshme në varësi të temave të trajtuara, disponueshmërisë dhe aftësive të secilit.

Perspektivat e ekipeve edukative luajnë një rol parësor në ndërtimin e këtyre proceseve të bashkëpunimit, ku kontributi nga prindërit është tejet i rëndësishëm. Prandaj, është e dobishme të reflektohet si ekip mbi metodën e përshtatshme për qasjen ndaj kontekstit familjar. Qasja ndikohet fuqimisht nga ideja që secili edukator\e ka për familjen në terma të përgjithshëm dhe nga kuptimi i tyre për

llojet e ndryshme të familjeve që mund të hasin. Gjetja e strategjive të përshtatshme për secilën familje, do të thotë të mbështetësh mendimet e secilit pjesëmarrës në dialog, të përmirësosh qasjen dhe ta bësh atë më të qasshme për familjen.

Mënyrat e përfshirjes së familjes dhe raporteve të singërta, janë të elaboruara më tej në **«Udhëzuesin Praktik për Mbështetjen e Zbatimit të Kurrikulës së EFH-së.»**

Mundësitë për pjesëmarrjen e prindërve në IEFH-të, me një fokus të fortë në bashkëpunim dhe qasje të përqendruara të fëmija përfshijnë:

### Të nxënit si proces i përbashkët:

- Ndarja e traditave familjare, tregimeve ose profesioneve për të pasuruar diskutimet në klasë/grup.
- Bashkëpunimi në projekte tematike ku fëmijët hulumtojnë dukuri të botës reale, duke përdorur kontributin e prindërve për të ofruar detaje nga jeta e tyre e përditshme.
- Ofrimi i mundësive për të nxënit bazuar në përvojë, duke sjellë materiale apo personazhe të ndryshme, si demonstrimi i një profesioni, diskutimi mbi një profesion ose realizimi i një aktiviteti në natyrë.

### Dokumentimi dhe informatat kthyesë

- Rishikimi i informatave dhe dokumentimeve të punës së fëmijëve të vendosura në klasa/grupe ose hapësira të përbashkëta, të cilat pasqyrojnë udhëtimet dhe përvojat edukative të fëmijëve.
- Dhënia e komenteve, sygjërimeve për punën e demonstruar, duke ofruar mendime për sjelljen e fëmijës tuaj ose duke zgjeruar të mësuarit në shtëpi.

Kontributi me rrëfime familjare, tregime ose vëzhgime që plotësojnë dhe pasurojnë dokumentimin, duke krijuar një lidhje të pandërprerë midis shtëpisë dhe institucionit të EFH-së.

## Punëtori dhe dialog

- Pjesëmarrja e prindërve/kujdestarëve ligjorë në dialogje për pedagogjinë, përmes qasjes profesionale dhe miqësore, duke ndihmuar prindërit të kuptojnë më mirë se si mësojnë fëmijët dhe si mund ta mbështesin këtë në shtëpi.
- Angazhimi i prindërve/kujdestarëve ligjorë në aktivitete praktike, si punëtori arti ose eksplorime shkencore, duke pasqyruar përvojat e fëmijëve në institucione parashkollore.
- Ndarja e përvojave me prindër të tjerë në diskutime të strukturuar, duke nxitur një komunitet mbështetës të fëmijëve.

## Bashkëpunimi në Projekte

- Ndihma nga prindërit/kujdestarët ligjorë në planifikimin dhe realizimin e projekteve duke ndarë njohuri ose duke siguruar burime (p.sh., mjete për një projekt ndërtimi ose njohuri për një eksplorim kulturor).
- Pjesëmarrja në aktivitetet e projekteve, si ndihma në hulumtime, shoqërimi gjatë ekskursioneve, ose asistimi në eksperimente në klasë/grup.
- Pjesëmarrja si audiencë për prezantimet e projekteve të fëmijëve, duke ofruar inkurajim dhe reagime konstruktive.

## Kontributet në Mjedis

- Sigurimi i materialeve natyrore ose të ricikluara për përdorim nga fëmijët në projekte artistike ose ndërtimi.
- Ndihma në organizimin e hapësirave të lojërave në natyrë ose kopshteve, duke inkurajuar qëndrueshmërinë dhe lidhjen me natyrën.
- Dhënia e sugjerimeve për mënyrën se si mund të riorganizohen ose përmirësohen hapësirat për të pasqyruar interesat dhe nevojat në zhvillim të fëmijëve.

## Ndërtimi i Komunitetit

- Pjesëmarrja në festa kulturore, festivale, ose aktivitete sezonale që bashkojnë familjet dhe vënë në pah diversitetin.
- Vullnetarizmi për projekte shërbimi komunitar ose nisma për përmirësimin e institucionit/shkollës.
- Kontributi në mbrëmje familjare, përgatitje të drekave të përbashkëta, ose aktivitete prind-fëmijë që promovojnë lidhje joformale midis familjeve dhe stafit.

## Vendimmarrja

- Këshillet ose aktivet e prindërve që ofrojnë kontribut në politikat, fokusin e kurrikulës, ose iniciativat komunitare.
- Diskutime bashkëpunuese me edukatorët dhe administratorët për të harmonizuar objektivat e IEFH-së me nevojat e familjes dhe komunitetit.
- Forume të rregullta ku prindërit mund të shprehin opinionet e tyre dhe të sugjerojnë përmirësime.

## Ndërveprimet e Përditshme

- Biseda të përditshme gjatë orëve të dorëzimit ose marrjes së fëmijës, duke mundësuar informimin për progresin ose sfidat e fëmijës.
- Ndarja e vëzhgimeve rreth sjelljes së fëmijës në shtëpi, që mund të informojë dhe plotësojë edukimin që ndodh në IEFH.
- Bashkëpunimi për plane individuale për të mbështetur nevojat unike zhvillimore të fëmijës, duke siguruar konsistencë midis mjedisit të shtëpisë dhe IEFH-së.

Këto mundësi bazohen në bindjen se prindërit/kujdestarët ligjorë, janë bashkëedukatorë, jo thjesht vëzhgues pasivë. Duke u angazhuar në mënyra kuptimplote, familjet ndihmojnë në krijimin e një ekosistemi të pasur dhe dinamik të të nxënimit që ushqen jo vetëm fëmijët, por edhe komunitetin më të gjerë edukativ. Kjo qasje vlerëson prindërit si bashkëedukatorë,



duke njohur rolin e tyre thelbësor në krijimin e një ekosistemi të pasur dhe të ndërlidhur të të nxënit.

#### 4.9 Tranzicionet

Tranzicioni për fëmijët nga familja në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, nga grupi në grup, nga një institucion në tjetrin dhe nga edukimi i hershëm në arsimin fillor, janë aspekte qendrore për nxitjen e zhvillimit të fëmijës nga pikëpamja emocionale dhe sociale. Akterë të ndryshëm janë thelbësorë dhe përgjegjës në përcaktimin dhe përcjelljen e fëmijës në kalimin e këtyre fazave në kontekste të ndryshme të jetës dhe të të nxënit. Suksesi i këtyre proceseve varet nga bashkëpunimi dhe përcaktimi i bashkëpërgjegjësive edukative ndërmjet akterëve të ndryshëm referues të fëmijës. Për këtë, është e nevojshme të vendosen masa efektive, të identifikohen dhe ofrohen mënyra mbështetëse për marrëdhënien familje-institucion dhe anasjelltas, dhe për të aktivizuar dhe zhvilluar rrjete komunikimi si një burim për familjen që ndër të tjera inkurajon edhe rrjetëzimin ndërmjet shërbimeve të

ndryshme në një zonë/regjion.

Edukimi dhe kujdesi i cilësisë së lartë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës jo vetëm në arritjet e të nxënit dhe edukative - aftësitë kognitive siç janë shkrim-leximi (në mënyrën e tyre) dhe llogaritja, sjellja sociale dhe emocionale dhe përgatitja për marrëdhëniet shoqërore - por edhe për ndikimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm në performancën dhe pjesëmarrjen në faza të mëvonshme të edukimit. Që të ndodhë kjo, sistemi edukativo-arsimor duhet të jetë i integruar dhe koherent. Fëmija, që kalon nga institucioni i edukimit në fëmijërinë e hershme në shkollë, e që e fillon shkollën pozitivisht, ka më shumë gjasa ta perceptojë shkollën si një vend të rëndësishëm, të sigurt dhe të besueshëm, të ketë një qëndrim pozitiv ndaj të nxënit dhe të ketë pritshmëri pozitive për aftësitë e veta dhe të nxënit gjatë gjithë jetës. Megjithatë, kjo do të ndodhë nëse tranzicioni i fëmijës nëpër sistemin edukativo-arsimor është i organizuar mirë dhe harmonik.

Procesi i tranzicionit duhet të ndodhë gradualisht; ai duhet të fillojë shumë më herët se sa fëmija të fillojë shkollën apo institucionin dhe të sigurohet që fëmija dhe familja të

kenë ndjenjën e përkatësisë në institucion\shkollë dhe që edukatori/-ja ta kuptojë dhe ta mbështesë këtë.

### Tranzicioni i suksesshëm

Fillimi i edukimit në institucionin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme përfshin pjesëmarrjen e fëmijës dhe të pjesëmarrësve të tjerë, siç janë familja, stafi edukativ, profesional dhe menaxherial i institucionit. Prandaj, tranzicionet e suksesshme varen nga natyra e marrëdhënieve dhe komunikimit ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në edukimin e hershëm të fëmijës. Miqësia e fëmijëve, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe marrëdhëniet me edukatorët e tyre janë jetike.

Literatura tregon se ekzistojnë disa procese thelbësore, të cilat duhet të zhvillohen në vazhdimësi në mënyrë që tranzicioni të realizohet me sukses, si:

- Politika që mbështetin strukturat e reja zhvillimore dhe që ndërlihdin nivelet e edukimit;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i edukatoreve, si në nivelin teorik ashtu edhe atë praktik;
- Vazhdimësia e komunikimit me mjedisin familjar dhe komunitetin.

Tranzicioni dhe fillimi i suksesshëm i shkollës janë identifikuar si faktorë që neutralizojnë disa avantazhe sociale dhe ekonomike dhe promovojnë qëndrueshmërinë e të nxëniet.

Fëmija që e fillon institucionin\shkollën pozitivisht ka më shumë gjasa ta perceptojë institucionin\shkollën si një vend thelbësor, të ketë një qëndrim pozitiv ndaj të nxëniet dhe të zhvillojë pritshmëri pozitive ndaj aftësive të veta të cilat i zhvillon gjatë jetës.

Tranzicioni i suksesshëm është jetik për mirëqenien emocionale dhe zhvillimin kognitiv të fëmijës; tranzicioni mund të lehtësojë gjithashtu integrimin e hershëm të grupeve me origjinë të ndryshme, duke u bërë një faktor i domosdoshëm për gjithëpërfshirje. Tranzicionet pozitive janë gjithashtu në gjendje të reduktojnë pasojat negative të përjetimit të ndryshimit, si fobia nga institucionin\shkolla, analfabetizmi funksional, shkalla e braktisjes së shkollës etj., duke promovuar kështu mundësi të barabarta në kohën e fillimit të arsimit të detyrueshëm.

Në Udhëzuesin Praktik që ndihmon zbatimin e kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme, janë shpjeguar dhe janë dhënë strategji praktike për llojet e tranzicioneve, të cilat janë:

- Tranzicioni nga shtëpia në IEFH (ditët e para)
- Tranzicioni nga shtëpia në IEFH dhe anasjelltas (çdo ditë)
- Tranzicionet e përditshme
- Tranzicioni në shkollën fillore

# Kapitulli V

Dokumentimi  
dhe vlerësimi në  
procesin e të nxënimit





## 5. Dokumentimi dhe vlerësimi në procesin e të nxënit

### 5.1. Vlerësimi dhe të nxënit

**T**ë nxënit është një proces shoqëror dhe bashkëpunues. Kompetencat e paraqitura në këtë kurrikulë përvetësohen nga fëmijët përmes përvojave të organizuara të të nxënit, si në mjedise të institucioneve të EFH-së, ashtu edhe jashtë saj. Kurrikula zbatohet nga stafi edukativ dhe ndikimi në të nxënit e fëmijëve varet nga shumë faktorë, përfshirë qasjet dhe metodologjitë pedagogjike, mjedisi dhe materialet, të cilat reflektohen në vlerësim të progresit tek fëmijët. Procesi i vlerësimit duhet të jetë i vazhdueshëm dhe koherent gjatë zbatimit të gjithë kurrikulës. Fjalori i Terminologjisë së Kurrikulës i IBE-UNESCO (2013) e përkufizon Vlerësimin për të nxënit si “Vlerësim i progresit dhe arritjeve të fëmijës, qëllimi kryesor i të cilit është të mbështesë dhe përmirësojë të nxënit duke përshtatur procesin edukativ për të përmbushur nevojat e fëmijës”.

Zakonisht, vlerësimi është proces i mirëpërkufizuar, i përcaktuar dhe i qëllimshëm, dhe nuk duhet të përpilohet dhe të lexohet si gjykim. Ky proces përfshin përcjelljen dhe vëzhgimin, dokumentimin dhe interpretimin e sjelljes, aftësive dhe përvojave të fëmijëve në mënyrë që të ndihmojë edukatorët dhe prindërit\kujdestarët ligjorë të marrin vendime të informuara që mbështesin zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës. Vlerësimi në EFH synon të ndihmojë fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë duke krijuar një mjedis mbështetës dhe të përshtatur për të nxënit dhe zhvillimin e tyre në të gjitha aspektet. Qëllimi i vlerësimit në edukimin e hershëm NUK është matja e performancës së fëmijëve përmes testimit të standardizuar.

Qëllimi i vlerësimit ËSHTË vëzhgimi dhe dokumentimi i momenteve të tyre zhvillimore,

proceseve të edukimit dhe ndërveprimeve të tyre me synim mbështetjen e zhvillimit të plotë të tyre në një mënyrë të përshtatur dhe të ndjeshme ndaj nevojave individuale.

Për t’iu qasur konceptit kompleks të vlerësimit, duhet marrë parasysh konteksti në të cilin do të realizohet vlerësimi. Për t’i dhënë kuptim konceptit të vlerësimit në moshën e hershme, është e nevojshme të kuptohet drejtë se çfarë do të thotë edukimi në fëmijërinë e hershme.

Vlerësimi është pjesë e çdo programi cilësor të edukimit gjatë fëmijërisë së hershme. Kur edukatorët bëjnë një vlerësim, ata vëzhgojnë një fëmijë për të marrë informacion për atë që ai/ajo di dhe atë se çfarë mund të bëjë.

Vëzhgimi dhe dokumentimi i punës dhe performancës së një fëmije në vazhdimësi ia mundëson një edukatori/-eje të grumbullojë materiale dhe forma të ndryshme për zhvillimin dhe të nxënit e fëmijës. Me këtë informacion, edukatori/-ja mund të fillojë të bëjë plane efektive duke u bazuar në nevojat e çdo fëmije.

Vlerësimi efektiv përfshin edhe bashkëpunimin me familjen, duke marrë parasysh kontributet dhe perspektivat e prindërve\kujdestarëve ligjorë për të kuptuar më mirë zhvillimin dhe progresin e fëmijës. Ky model vlerësimi poashtu ndihmon prindërit të planifikojnë se si mund të ndihmojnë në shtrirjen e zhvillimit dhe të nxënit në shtëpitë e tyre.

Vlerësimi në EFH ndihmon edhe në zbulimin e hershëm të sfidave ose vështirësive të mundshme në zhvillimin e fëmijës, duke mundësuar edhe referime për ndërhyrje të hershme dhe mbështetje të specializuara. Kjo është thelbësore për të ndihmuar fëmijët të kapërcejnë çdo pengesë në fazat e hershme të jetës.

Ju lutem shihni Udhëzuesin praktik që ndihmon zbatimin e Kurrikulës së EFH-së.

Duhet të merret parasysh fakti se fëmijët në moshën e hershme angazhohen në reflektim

dhe vetëvlerësim duke ndërtuar një vetëdije lidhur me të nxënit e tyre. Stafi edukativ mbështet vetëvlerësimin tek fëmijët duke përdorë teknika të ndryshme, si për shembull diskutime reflektuese me pyetje të hapura në grupe të vogla, të cilat kanë për qëllim të nxitin fëmijët të mendojnë dhe të shtjellojnë përvojën e tyre, motivet, dhe mënyrat për veprimet që i kanë ndërmarrë gjatë realizimit të aktiviteteve. Ky lloj vetëvlerësimi ndërlidhet me situatat përkatëse dhe nuk duhet të përgjithësohet për të vlerësuar arritjet e fëmijës. Stafi edukativ përfshin momentet e tilla reflektuese në vlerësimin e tyre për fëmijët.

## 5.2. Vëzhgimi

Fëmijët janë të ndryshëm dhe kanë inteligjenca, gjuhë dhe strategji të ndryshme për të zbuluar dhe për t'i dhënë kuptim botës. Puna e edukatorit/-es është të mbështesë strategjitë dhe proceset e tyre të të nxënit. Duhet të merret parasysh se nuk ekziston ndonjë vëzhgim plotësisht objektiv. Prandaj, vëzhgimi është subjektiv dhe pjesëmarrës. Aq më tepër kur bëhet nga edukatorë, të cilët ndajnë përvoja dhe tregime me fëmijën, e që, për rrjedhojë, nuk mund të kenë një këndvështrim objektiv dhe të shkëputur.

Para se të fillohet me vëzhgimin, duhet të jetë e qartë se në çfarë do të fokusohet vëzhgimi, pasi që është e paimagjinueshme që mund të vëzhgohet gjithçka. Le të mendojmë për përvojën e një fëmije të vogël në njohuri dhe eksplorim të materialit të ri. Stafi edukativ mund të vëzhgojë përdorimin e shqisave, hezitimet dhe entuziazmin, atë se çfarë krijon me materialin e ri, vëzhgimin nga fëmija se çfarë po bëjnë miqtë e tij dhe marrëdhëniet e vendosura midis fëmijëve që bëjnë të njëjtën gjë, e shumë më tepër.

Të vendosurit e qëllimit të vëzhgimit dhe ndarja e qëllimit me stafin tjetër edukativ, ndihmon në vëzhgim dhe dokumentim. Zgjedhja e objektit të vëzhgimit duhet të bëhet në harmoni me aktivitetin ose projektin e planifikuar për t'u realizuar. Stafi edukativ vëzhgon proceset e të nxënit të fëmijëve dhe i dokumenton ato në forma të ndryshme: duke marrë shënime, duke transkriptuar dialogun e fëmijëve, duke bërë fotografi dhe video, apo forma të tjera të përshtatshme për situatën.

## 5.3. Dokumentacioni pedagogjik

Dokumentet janë bazë për vlerësim. Procesi i dokumentimit përshkruhet si një përmbledhje e “gjurmëve” të të nxënit dhe të “dëgjimit të dukshëm”. Qëllimi i dokumentacionit është ta bëjë nxënien të dukshme, gjë që mundëson diskutim dhe interpretim bashkëpunues me të tjerët për të zhvillur planin edukativ për nxenie dhe përvoja të mëtejshme. Planifikimi se çfarë duhet bërë më pas me fëmijët lind nga diskutimi dhe interpretimi i dokumentacionit; në këtë mënyrë, dokumentacioni pedagogjik kontribuon në një kurrikulë me fëmijët në qendër.

Dokumentacioni pedagogjik është një mjet qenësor për të nënkuptuar proceset e të nxënit të fëmijës dhe thelbin e procesit edukativ në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme. Dokumentacioni nënkuptohet si një mjet didaktik që identifikon dhe bën të dukshme praktikatat dhe proceset njohëse të fëmijës dhe të rriturit. Këto procese bëhen të dukshme duke interpretuar dhe ndarë teorinë, njohuritë dhe mendimet. Institucionet e EFH-së ofrojnë një mjedis të sigurtë dhe një “jetë të mirë” brenda tij. Dokumentacioni pedagogjik është një mjet i nevojshëm për të mbështetur mendimin dhe interpretimin konstruktiv dhe reflektues, pra është një mjet që lidhë edukatorin, prindin dhe fëmijën në nivele të ndryshme. Dokumentacioni lejon vlerësimin të bazohet në kontekst, duke nxjerrë në pah procese që prekin të gjitha aspektet e “të jetuarit” në institucionin e EFH-së.

Vlerësimi për të dëshmuar përparimin dhe zhvillimin e mendimeve dhe ndjenjave të fëmijëve është poashtu një mjet i vlefshëm për vetëdijësimin e stafit edukativ për kufizimet e njohurive të tyre. Bazuar në këtë vetëdijësim, stafi edukativ, por edhe prindërit/kujdestarët ligjorë, mund të zgjerojnë të kuptuarit e tyre, të përmirësojnë reagimin e tyre emocional ndaj proceseve të të nxënit të fëmijës dhe të thellojë ndjenjën e tyre të lidhjes me fëmijët.

Çdo institucion i edukimit në fëmijërinë e hershme mund të përdorë metoda, strategji dhe instrumente të ndryshme dokumentimi, duke përfshirë:

- ditarët e përditshëm,
- projektet tematike,
- publikimet,



- imazhet fotografike,
- video regjistrimet apo të tjera të ngjashme.

Çdo strategji dokumentimi u lejon prindërve/kujdestarëve ligjorë të shohin disa fragmente të jetës së përditshme në institucion e EFH-së dhe të flasin me fëmijën e tyre për përvojat e bëra të dukshme (të dokumentuara).

#### 5.4. Dokumentimi i vlerësimit (shpeshtësia dhe forma)

Edukatorët gjatë vitit duhet të mbledhin vëzhgimet dhe dokumentacionin dhe të përpilojnë vlerësimin periodik në nivel individual për fëmijët, dy herë brenda vitit edukativ. Përderisa vëzhgimi dhe dokumentacioni pedagogjik janë procese të vazhdueshme dhe informojnë vlerësimin, procesi i dokumentuar i vlerësimit që përfshin plotësimin e formavë përkatëse dhe bashkëpunimin me prindërit/kujdestarët ligjorë, realizohet së pari në mes të vitit edukativ, apo pas periudhës së mjaftushme për vëzhgim dhe dokumentim (jo më pak se tre muaj), dhe së dyti, në fund të vitit edukativ.

Vlerësimi periodik kërkon që stafi edukativ të:

- hartojnë një dokument që përmban të dhëna për secilën kompetencë dhe një përshkrim lidhur me përparimin dhe sfidat e fëmijës në kompetencën përkatëse. Përshkrimi duhet të jetë i qartë dhe konciz dhe të ketë ndërlidhje me dokumentacionin që përmban detajet përkatëse.

- japin të paktën një dokumentacion (ose pjesë dokumentacioni) për çdo kompetencë në të cilën ka punuar fëmija. Dokumentacioni duhet të përfshijë momente të ndryshme nga më shumë se sa një aktivitet i vetëm, nga periudha të ndryshme kohore të përfshira në vlerësim. Nuk është e domosdoshme që ky vlerësim të jetë individual, por mund të jetë pjesë e dokumentimit të një projekti edukativ.

Modele të hartimit të këtyre dokumenteve gjinden në Udhëzuesin e zbatimit të Kurrikulës për EFH-në.

Përveç vlerësimit periodik, stafi edukativ në baza javore zhvillon raporte përmbledhëse javore për grupin përkatës edukativ duke përshkruar aktivitetet e realizuara gjatë javës së kaluar, përfshirë kompetencat e synuara për t'u zhvilluar, përparimin dhe interesat e shfaqura të fëmijëve gjatë realizimit të aktiviteteve dhe mënyrën e realizimit të tyre, dhe duke shfaqur dokumentacione që mbështetin raportin, si për shembull sekuenca të dialogut apo reagimeve të fëmijëve. Gjatë përpilimit të raportit javor, edukatorët ndajnë mes vete përvojat dhe vëzhgimet e tyre në nivel të grupit dhe të fëmijëve. Ato poashtu komunikojnë dhe marrin përvojën e bashkëpunëtorëve profesionalë që mbështetin procesin edukativ në grup. Në këtë mënyrë, raporti është më objektiv, më i besueshëm dhe i bazuar në reflektim dhe dokumentacion nga të gjitha palët e përfshira në proces edukativ.

Këto raporte përmbledhëse javore ndahen me prindërit/kujdestarët ligjorë të grupit përkatës në fund të çdo jave.



# Kapitulli VI

Fjalorthi  
i kurrikulës





## 6. Fjalorthi i kurrikulës

### Llogaridhënia

Në terma të përgjithshëm, llogaridhënia është një proces me anë të të cilit aktorët japin arsyet për veprimet e tyre kundrejt pasojave të mundshme negative (ose pozitive). Koncepti i llogaridhënies është themelor në sistemet e arsimit të decentralizuar që inkurajojnë autonominë e institucionit edukativo-arsimor, duke përfshirë vendimet në lidhje me kurrikulën.

### Edukimi në Fëmijërinë e Hershme

I referohet edukimit të fëmijëve për t'i stimuluar në arritjen e potencialit të tyre të plotë nga lindja deri në momentin që hyjnë në klasën e parë në shkollën fillore.

### Edukimi parafilor

Është paraparë zakonisht për fëmijët nga mosha 3 vjeç deri në fillimin e shkollës fillore. Vetitë edukative të edukimit parafilor karakterizohen nga ndërveprimi me bashkëmoshatarët dhe edukatorët, përmes të cilit fëmijët përmirësojnë përdorimin e gjuhës dhe aftësive sociale dhe fillojnë të zhvillojnë aftësitë logjike dhe të arsytimit.

Fëmijët gjithashtu njihen me konceptet alfabetike dhe matematikore dhe inkurajohen të eksplorojnë rrethinën dhe mjedisin e tyre. Aktivitetet motorike bruto të mbikëqyrura (p.sh. ushtrimet fizike përmes lojërave dhe aktiviteteve të tjera) dhe aktivitetet e bazuara në lojë mund të përdoren si mundësi mësimi për të promovuar ndërveprimet sociale me bashkëmoshatarët dhe për të zhvilluar aftësitë, autonominë dhe gatishmërinë për shkollë. **Edukimi parafilor** në Kosovë është program edukativ për fëmijë të moshës pesë (5) vjeçare, i cili ofrohet në kuadër të shkollës fillore dhe në institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme.

### Takimi i mëngjesit

Është koha që grupi ose klasa i kushton një bisede formale dhe joformale lidhur me atë që po ndodhe në institucion, ngjarjet personale dhe kolektive dhe në përgjithësi, si dhe është një kohë për reflektim, bashkëprojektim dhe analizë të dokumentacionit.

### Dokumentimi

Dokumentimi i bën proceset e të mësuarit të fëmijës të dukshme për të informuar veprimet edukative dhe për të gjeneruar njohuri dhe kërkime. Dokumentimi nuk është një akt vetëm për familjet, për transparencën për të komunikuar dhe për të bërë të qasshme atë që ndodhë brenda shërbimit edukativ, të cilat janë momentet e rëndësishme të të nxënit, marrëdhënien dhe zbulimin e fëmijës që na besojnë.

Dokumentimi do të thotë gjithashtu ndërtimi i një kujtese të përvojave edukative, konfirmimi i asaj që ne besojmë se ka ndodhur mes fëmijëve duke u përpjekur të interpretojnë ngjarje të mundshme dhe kapjen e aspekteve të padukshme, por domethënëse të proceseve të rritjes të fëmijërisë.

### Edukimi që u jepet fëmijëve shumë të vegjël

Nga të porsalindurit deri në gjashtë vjeç dhe misioni i të cilit është t'i edukojë dhe socializojë ata mbi shtyllat e lojës dhe përfshirjes.

I quajtur edhe në disa pjesë të botës si edukimi fillestar ose edukimi themelor, ai ofrohet në institucione të specializuara edukative, mjedise formale ose joformale, me lehtësim dhe mbikëqyrje nga edukatorët, kujdestarët ose, në disa raste (shkollimi në shtëpi), nga prindërit/kujdesatarët ligjorë. Ato mund të quhen institucione të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, qendra me bazë në komunitet, kopshte private, publiko-private, qendra për fëmijë të vegjël ose çerdhe.

## Njohja me institucionin e edukimit në fëmijërinë e hershme\adaptimi

Fillimi i vitit edukativ\shkollor është koha kur fëmija ndjek për herë të parë institucionin edukativ, njihet me kontekstin edukativ, edukatorin/-en, mjedisin edukativ, kohën dhe organizimin dhe së fundi me fëmijët e tjerë. Prindërit mund të qëndrojnë pjesërisht në institucion për ta lehtësuar procesin e njohjes.

## Qasja multidisiplinare

Edukimi ndërdisiplinor përfshin përdorimin dhe integrimin e metodave dhe kornizave analitike nga ose të lidhura me disiplina të shumta për të shqyrtuar një temë, problem, pyetje, ose trajtuar një temë. Edukimi ndërdisiplinor përdor qasje disiplinore për t'i shqyrtuar temat. Megjithatë, ai shkon më tej: marrja e njohurive nga disiplina të ndryshme përkatëse dhe sintetizimi i kontributit të tyre për të kuptuar, si dhe integrimi i këtyre ideve në një kornizë analitike më gjithëpërfshirëse dhe koherente.

## Inteligjenca të shumëfishta

Me teorinë e inteligjencës së shumëfishtë, Howard Gardner demonstroi se nuk ka një inteligjencë të vetme, por nëntë, të cilat i referohen po aq strukturave të pavarura të trurit. Kjo do të thotë që një individ është inteligjent në nëntë mënyra edhe nëse, në realitet, pjesët e ndryshme të inteligjencës kombinohen dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

## Arsimi joformal

Arsimi joformal është lloji i edukimit që zhvillohet jashtë kurrikulës së arsimit formal. Aktivitetet e të nxënësve joformal janë të dizajnuara vullnetarisht dhe me kujdes për të nxitur zhvillimin personal, social dhe profesional të pjesëmarrësve.

## Numërimi

Numërimi është aftësia për të arsyetuar dhe zbatuar koncepte të thjeshta numerike. Shkathtësitë bazë të numërimit konsistojnë në të kuptuarit e matematikës themelore si mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi.

## Vëzhgimi

Vëzhgimi është i nevojshëm që edukatori/-ja të njohë, dokumentojë dhe interpretojë proceset edukative të fëmijës në kontekstin edukativ. Kjo lejon të grumbullohen elemente për të zhvilluar synimet edukative, për të krijuar zgjedhje të përbashkëta dhe për të gjeneruar njohuri në lidhje me proceset e të nxënësve.

## Vlerësimi i portofolit

Vlerësimi bazohet në mbledhjen sistematike të punës së fëmijës (si detyrat në të shkruar, draftet, veprat artistike dhe prezantimet) që përfaqësojnë kompetencat, punën ose përparimin zhvillimor të fëmijës. Përveç shembujve të punës së tyre, shumica e portofolave përfshijnë deklarata reflektuese të përgatitura nga fëmija. Portofolat vlerësohen për dëshmi të arritjes së fëmijës në lidhje me rezultatet dhe standardet e përcaktuara të të nxënësve.

## Shkathtësia

Aftësia për të kryer detyra dhe për t'i zgjidhur problemet. (Burimi: CEDEFOP 2011). Aftësia, zotësia ose talenti për të kryer detyra vjen nga edukimi, trajnimi, praktika ose përvoja. Mund të mundësojë zbatimin praktik të njohurive teorike në detyra ose situata të veçanta. Zbatohet më gjerësisht për t'i përfshirë sjelljet, qëndrimet dhe atributet personale që i bëjnë individët më efektivë në kontekste specifike si edukimi dhe trajnimi, punësimi dhe angazhimi social.

**Edukimi gjithëpërfshirës** - Edukimi është krijuar për të lehtësuar të nxënësve nga individë të cilët, për arsye të ndryshme, kërkojnë mbështetje shtesë dhe metoda pedagogjike adaptive për të marrë pjesë dhe për t'i përmbushur objektivat e të nxënësve në një program edukativ.

Programet edukative në arsimin për aftësinë e kufizuar mund të ndjekin një kurrikulë të ngjashme me atë të ofruar në sistemin e edukimit të rregullt. Megjithatë, ato marrin parasysh nevojat individuale duke ofruar burime specifike (p.sh. personel, pajisje ose hapësirë të trajnuar posaçërisht) dhe, nëse është e përshtatshme, përmbajtje të modifikuara edukative ose objektiva

edukative. Këto programe mund t'i ofrohen fëmijës në mënyrë individuale brenda programeve edukative tashmë ekzistuese ose si një klasë/grup i veçantë në të njëjtat institucione edukative ose të veçanta. (Burimi: UIS 2012).

### **Të mësuarit social dhe emocional (SEL)**

Të mësuarit se si të menaxhohen ndjenjat dhe marrëdhëniet me të tjerët. Kjo përfshin gjithashtu njohjen e emocioneve dhe ruajtjen e marrëdhënieve pozitive në zhvillimin e empatisë dhe ndjeshmërisë. Ai përfshin marrjen e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që fëmija kanë nevojë për të krijuar marrëdhënie pozitive, për të ndërtuar qëndrueshmëri, për të trajtuar situata sfiduese, për të marrë vendime të përshtatshme dhe për t'u kujdesur për të tjerët. Zakonisht, ai lëviz fokusin në aftësi të tilla si vetëdërgjegjësimi, vetëmenaxhimi, ndërgjegjësimi social, aftësitë e marrëdhënieve dhe vendimmarrja e përgjegjshme. Përparimet e fundit në neuroshkencë kanë hedhur dritë të re mbi rolin e proceseve jokognitive në arsyetimin dhe ndërgjegjen njerëzore, duke bërë revolucion të të menduarit në lidhje me rolin e ndjenjës dhe intuitës në zgjidhjen e problemeve të reja. Ndërsa pikëpamja tradicionale mund të ketë qenë se ndjenjat ndërhyjnë në aftësinë e një individi për t'i zgjidhur problemet, kjo fjalë e urtë dështoi të theksojë se në mungesë të ndjenjës, një individ nuk ka gjasa ta zgjidhë problemin. (Përshtatur nga: Seel 2012).

### **Aftësitë e buta**

Termi tregon një grup cilësish, tiparësh, atributësh, zakonësh dhe qëndrimesh të paprekshme personale që mund të përdoren në shumë punë. Duke qenë se ato janë gjerësisht të zbatueshme, ato shihen gjithashtu si aftësi të transferueshme, edhe nëse transferimi shpesh vihet në pikëpyetje sepse individët mësojnë të kryejnë detyra në kontekste të veçanta dhe mund të mos jenë në gjendje t'i zbatojnë ato tek të tjerët. Aftësitë e buta përfshijnë ndjeshmërinë, udhëheqjen, ndjenjën e përgjegjësisë, integritetin, vetëvlerësimin, vetëmenaxhimin,

motivimin, fleksibilitetin, shoqërueshmërinë, menaxhimin e kohës dhe vendimmarrjen. Termi përdoret gjithashtu në kontrast me aftësitë 'e forta' që konsiderohen më teknike, të veçanta në natyrë dhe të veçanta për një profesion, dhe që mund të mësohen (përgjithësisht) më lehtë sesa aftësitë e buta.

### **Kurrikula spirale**

Hartimi i kurrikulës (bazuar në idetë e psikologut amerikan Jerome Bruner), në të cilin konceptet dhe temat kryesore paraqiten në mënyrë të përsëritur me kalimin e kohës në kontekstin e përvojave të reja, më të gjera dhe më komplekse të të nxëniet. Kurrikula shërben për të konsoliduar të nxëniet paraekzistues si dhe për të zgjeruar dhe eksploruar më në thellësi përmbajtjen e ndryshme edukative.

### **Standardi/-et**

Standardi është një dokument që ofron kërkesa, specifikime, udhëzime ose karakteristika që mund të përdoren vazhdimisht për të siguruar që materialet, produktet, proceset dhe shërbimet i përshtaten qëllimit të tyre. (Burimi: Uebfaqja e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim-ISO).

### **Mësimdhënia**

Ka qasje të ndryshme të mësimdhënies që pasqyrojnë në mënyrë implicite qasjen ndaj të nxëniet. Qasja didaktike përfshin kryesisht ligjërimin dhe zakonisht është e përqendruar te edukatorët dhe e orientuar nga përmbajtja, d.m.th., mësimdhënia si një transmetim ku fëmija konsiderohet marrës pasiv i informacioneve të transmetuara. Mësimdhënia mund të shihet gjithashtu si mbështetje e procesit të ndërtimit dhe të kuptuarit të njohurive të fëmijës, duke u ndërtuar mbi atë që tashmë njihet nga fëmija dhe duke përfshirë një qasje të përqendruar te fëmija (p.sh., mësimdhënia si lehtësim). Një qasje tjetër thekson zhvillimin e proceseve njohëse të fëmijës, ndërgjegjësimin dhe kontrollin e të menduarit dhe të të nxëniet.

### **Ndarja e kohës**

Sasia e kohës që i kushtohet edukimit në një disiplinë të caktuar sipas rregulloreve, kërkesave ose rekomandimeve zyrtare.

Duhet të dallohet nga koha që shpenzohet për të mësuar.

## Transdisiplina

Transdisiplinariteti është një qasje ndaj dijes që bazohet në kontributet kulturore nga shumë fusha për të përballuar sfidat brenda shoqërisë sonë. Kjo qasje ndërthur ide nga fusha të ndryshme, duke krijuar njohuri që janë të dobishme si në teori ashtu edhe në praktikë.

Transdisiplinariteti tejkalon plotësisht kufijtë tradicionalë midis disiplinave. Ai formon mënyra të reja të menduarit, të bazuara në ndërlikohen midis pikëpamjeve të ndryshme kulturore. Kjo qasje mbështet krijimin e zgjidhjeve të integruara dhe të qëndrueshme për problemet komplekse duke përdorur një perspektivë gjithëpërfshirëse dhe inovative.

## Qasja transdisiplinore

Një qasje ndaj integritit të kurrikulës që shpërndan kufijtë midis disiplinave konvencionale dhe organizon mësimdhënien dhe të nxënit rreth ndërtimit të kuptimit mbi problemet ose temat e botës reale.

## Tutorimi

Mbikëqyrja nga një profesionist me përvojë dhe kompetent. Tutori e mbështet fëmijën gjatë gjithë procesit edukativ (në shkollë, në qendra trajnimi ose në punë). Tutorimi mund të mbulojë: lëndët akademike për të përmirësuar arritjet edukative, karrierën për të lehtësuar kalimin nga shkolla në punë dhe zhvillimin personal për të inkurajuar fëmijën të bëjë zgjedhje të mençura. (Burimi: CEDEFOP 2011).

## Vlerat

Parimet e përcaktuara kulturalisht dhe besimet thelbësore të përbashkëta nga individë dhe grupe që drejtojnë dhe motivojnë qëndrimet, zgjedhjet dhe sjelljet, duke shërbyer si udhëzime të gjera për jetën shoqërore.

## Mirëqenia (në IEFH dhe në shkollë)

Mirëqenia në shkollë kontribuon në shëndetin dhe zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve. Si e tillë, ajo është e lidhur fort me të nxënit.

Ajo përbëhet nga komponentë njohës, emocionalë dhe fizikë, d.m.th., mendimet, ndjenjat dhe ndjesitë trupore të fëmijës.

Mirëqenia në IEFH në përgjithësi përfshin qëndrime dhe emocione pozitive ndaj IEFH-së; kënaqësi në IEFH; vetëkoncept akademik pozitiv; mungesë e shqetësimeve për IEFH; mungesë e ankesave fizike në IEFH; dhe mungesë e problemeve sociale. Mirëqenia kontribuon në ruajtjen e një baze pozitive për të nxënit në edukimin e hershëm. Nga ana tjetër, të nxënit është vendimtar për mirëqenien, sepse të nxënit e suksesshëm është një burim thelbësor i kënaqësisë në fëmijërinë e hershme. Kështu, mirëqenia dhe të nxënit në edukimin e hershëm janë koncepte të ndërvarura që ndikojnë njëra-tjetrën. (Burimi: Seel 2012).

## Biodiversiteti

Tradicionalisht përkufizohet si shumëllojshmëria e të gjitha formave të jetës në tokë. Përfshin numrin e specieve (gjallesave), variacionet e tyre gjenetike dhe ndërveprimin e këtyre formave të gjalla brenda ekosistemeve komplekse. Është një botë magjepsëse për eksplorimet e fëmijës, e cila trajtohet shprehimisht në aftësi të ndryshme të propozuara në kurrikulën tonë dhe që sot, me ndryshimet klimatike që po ndodhin, merr një rëndësi edhe më të madhe.

## Diskurset

Ne e përkufizojmë diskursin si shfaqjen e mendimit të dikujt si një akt i vetëm dhe individual i komunikimit gjuhësor. Është kritik në ndërtimin e personalitetit, aftësive dhe kulturës së një fëmije. Edukatori/-ja duhet ta mbështesë atë përmes një bisede korrekte dhe respektuese, pa paragjykime dhe gjykime shoqërore. Biseda mes fëmijës duhet të bëhet pjesë e përditshme e punës brenda IEFH-së, gjatë mbledhjes, në punë në grupe të vogla dhe në çdo moment tjetër kur fëmija ndjen nevojën ose të drejtën për të biseduar.

## Gjenerimi i stereotipave

Stereotipi është një opinion i paracaktuar për njerëzit ose grupet, i cili shpërfill vlerësimin e rastit individual dhe rezulton nga një proces paraardhës i mbipërgjithësimi dhe

mbithjeshtimit ose një operacioni të rremë deduktiv. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje gjenerimit të stereotipeve në kopshtin e fëmijëve, duke shmangur me kujdes gjykimin e fëmijës dhe përcaktimin e tij\ saj përmes karakteristikave specifike, dhe në vend të kësaj të përpiqemi gjithmonë të përdorim komunikim të hapur, të aftë për të përmirësuar pozitivisht secilën nga karakteristikat e tij\ saj.

### Vlerësimi

Në procesin e edukimit të fëmijëve, është thelbësore që si të rritur të jemi në gjendje

të vlerësojmë secilin prej proceseve dhe produkteve të tyre kulturore dhe t'u ofrojmë atyre kushtet më të mira për t'i zhvilluar kuriozitetet dhe aftësitë e tyre, individualisht dhe në grup. Të vlerësosh një person (dhe një fëmijë) do të thotë të vendosësh një person në një pozicion për të shprehur dhe nxjerrë në pah të gjitha aftësitë dhe cilësitë e tij\ saj, duke i besuar atij\ asaj një rol dhe detyra të përshtatshme. Të vlerësosh një fëmijë do të thotë ta mbështesësh në proceset e tij\ saj të të nxënit dhe ta inkurajosh përballë vështirësive, ta ndihmosh aty ku duhet dhe të sigurosh prezencën e duhur kur të nevojitet.



# Burimet

- Bateson, G., 1976: Steps to an Ecology of Mind: Collected Essays in Anthropology, Psychiatry, Evolution, and Epistemology 1st Edition, University of Chicago Press.
- Bromfenbrenner, U., 1979: The Ecology of Human Development: Experiments by Nature and Design, Harvard University Press
- Bruner, J., 1996: The Culture of Education, Harvard University Press.
- Dahlberg, G., Moss, P. and Pence, A., Beyond Quality in Early Childhood Education and Care. Languages of Evaluation – Routledge, 2nd edition, 2014
- Mmantsetsa Marope, Patrick Griffin, Carmel Gallagher, **Future Competences and the Future of Curriculum A Global Reference for Curricula Transformation**, IBE-UNESCO, 2017 ([Link]).
- Mmantsetsa Marope, and Yoshi Kaga, **Investing Against Evidence**, UNESCO, Paris, 2015
- Anna May Navarrete, **Assessment in the Early Years: The Perspectives and Practices of Early Childhood Educators**, Dublin Institute of Technology, 2015 [Link]
- Carla Rinaldi, The relationship between documentation and assessment, in Innovation in Education, Vol. 11, n. 1, Winter 2004
- Council Of The European Union. (2019). Council Recommendation of 22 May 2019 on High-Quality Early Childhood Education and Care Systems. ST/9014/2019/INIT.  
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019H0605%2801%29&qid=1627470989089>
- Council Of the European Union. (2021a). Council Resolution on a strategic framework for European cooperation in education and training towards the European Education Area and beyond (2021-2030). 6289/1/21 REV 1. <https://www.consilium.europa.eu/media/48584/st06289-re01-en21.pdf>
- Council Of The European Union. (2021b). Council Recommendation establishing a European Child Guarantee. <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9106-2021-INIT/en/pdf>
- European Commission/EACEA/Eurydice. (2014). **Eurydice Policy Brief: Early Childhood Education and Care 2014**. Luxembourg: Publications Office of the European Union.  
<https://op.europa.eu/en-GB/publication-detail/-/publication/25c63f11-c2cb-4c4c-a3cb-85d9b1eab93b/language-en>
- European Commission/EACEA/Eurydice. (2019). **Key Data on Early Childhood Education and Care in Europe – 2019 Edition**. Luxembourg: Publications Office of the European Union.  
[https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/key-data-early-childhood-education-and-care-europe-%E2%80%93-2019-edition\\_en](https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/key-data-early-childhood-education-and-care-europe-%E2%80%93-2019-edition_en)
- European Commission /EACEA/Eurydice. (2020). Structural Indicators for Monitoring Education and Training Systems in Europe – 2020: Overview of major reforms since 2015. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union.  
<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/1538f2e6-3907-11eb-b27b-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-178475363>
- European Commission /EACEA/Eurydice. (2021). **Teachers' and School Heads' Salaries and Allowances in Europe 2019/20**. Luxembourg: Publications Office of the European Union. [https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/sites/default/files/salaires\\_2019\\_20\\_0.pdf](https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/sites/default/files/salaires_2019_20_0.pdf)
- European Commission/EACEA/Eurydice. (2009). Tackling Social and Cultural Inequalities through Early Childhood Education and Care in Europe. Brussels: EACEA/Eurydice.

European Commission Childcare Network. (1996). **Quality Targets in Services for Young Children**. Brussels: CEC.

European Commission. (2006). Communication from the Commission to the Council AND to the European Parliament Efficiency and equity in European education and training systems. (COM (2006) 481 final). <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A52006DC0481>

European Commission. (2011). Communication from the European Commission: Early Childhood Education and Care – providing all children with the best start for the world of tomorrow. COM (2011) 66 final. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A52011DC0066>

European Commission. (2021a). Education and Training Monitor. [https://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/et-monitor\\_en](https://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/et-monitor_en)

European Commission. (2021b). Early childhood education and care. How to recruit, train and motivate well-qualified staff: final report. <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/47ba3c3a-6789-11eb-aeb5-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-220906644>

European Council. (2002). Presidency Conclusions. Barcelona European Council 15 and 16 March 2002. SN100/1/02 REV1. Brussels: European Council.

[https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/en/ec/69871.pdf](https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/69871.pdf)

European Union. (2014). Proposal for Key Principles of a Quality Framework for Early Childhood Education and Care. Brussels: European Commission. Working Group on Early Childhood Education and Care under the auspices of the European Commission. [https://ec.europa.eu/assets/eac/education/policy/strategic-framework/archive/documents/ecec-quality-framework\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/assets/eac/education/policy/strategic-framework/archive/documents/ecec-quality-framework_en.pdf)

Gunilla Dahlberg, Peter Moss and Alan Pence, *Beyond Quality in Early Childhood Education and Care*. Languages of Evaluation – Routledge, 2nd edition, 2014

KAGA, Y., BENNETT, J., & MOSS, P. (2010). Caring and learning together: A cross-national study on the integration of early childhood care and education within education. UNESCO.

Merita Shala, **Assessing gross motor skills of Kosovar preschool children**, Journal of Early Child Development and Care, Volume 179, 2009 – Issue 7

Mmantsetsa Marope, Patrick Griffin, Carmel Gallagher, **Future Competences and the Future of Curriculum A Global Reference for Curricula Transformation**, IBE-UNESCO, 2017 ([[Link](#)]).

UNESCO – International Bureau of Education, 2013, **Glossary of Curriculum Terminology**, Geneva, 2013

UNESCO – International Bureau of Education, 2013: Twenty-first-century skills. <https://www.ibe.unesco.org/en/glossary-curriculum-terminology/t/tenty-first-century-skills>

Gardner, H., 1991: *Art Education and Human Development*, Getty Education Institute for the Arts, U.S.A.

Morin, E.: 1999: *Une tête bien faite. Repenser la réforme, réformer l'pensée*, 1999

Papert, S., 1993: *1993 - The Children's Machine: Rethinking School in the Age of the Computer*. New York: Basic Books.

Piaget, J, 1966: *La psychologie de l'enfant*, Jean Piaget et Bärbel Inhelder, Quadrige, PUF.

Prigogine, I., (1961). *Introduction to Thermodynamics of Irreversible Processes (Second ed.)*. New York: Interscience.

Vygotsky, L. S., 1933: *Play and its role in the Mental Development of the Child*.

# FALËNDERIM

## KURRIKULA PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME

Kontribuesit që morën pjesë në hartimin, pilotimin dhe finalizimin e Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme janë të shumtë, si: Kabineti i Ministres, Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Divizioni i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, Divizioni për Kurrikula dhe Mbështetje të Mësuesve, Inspektorati i Arsimit, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe Fakultetet e Edukimit.

MASHTI falënderon për kontributin dhe mbështetjen dhënë këtij procesi të gjithë anëtarët e Grupit Punues, ekspertin ndërkombëtar të angazhuar për mbështetjen e procesit - z. Cristian Fabbì, anëtarët e tjerë që kontribuan gjatë takimeve me fokus grupe të interesit, Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme, edukatorët, zyrtarët e DKA-ve, Inspektorët e Arsimit, zyrtarët e MASHTI, profesorët universitarë, trajnerët, studentët e të tjerë.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mënyrë të veçantë falënderon të gjithë udhëheqësit e procesit nga MASHTI dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë – UNICEF-in në Kosovë për mbështetjen dhe kontributin e pakursyer për zhvillimin dhe pilotimin e suksesshëm të Kurrikulës.

Ky falënderim shkon edhe për të gjithë kontribuuesit e tjerë si: Bankën Botërore, Caritas-in Zviceran, Save the Children, dhe Qendra për Studime Humane dhe Zhvillim. Hartimi, pilotimi dhe finalizimi i dokumentit të Kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme, nuk do të ishte i mundur pa kontributin e tyre të çmueshëm.

Kurrikula për edukimin në fëmijërinë e hershme u pilotua në 10 komuna, në 13 institucione të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe në 17 klasë parafillore. Për fazën pilotuese, u hartua edhe një raport me të gjeturat e këtij procesi të cilat u përfshin në dokumentin final të Kurrikulës.

Vendimi i grupit punues të angazhuar me vendim nga MASHTI, është paraqitur me qëllim, që të jemi më afër përdoruesve të këtij dokumenti dhe të ofrojmë sqarime plotësuese e përgjigje në pyetjet eventuale, për dokumentin në tërësi apo për udhëzuesit praktik që janë pjesë e dokumentit të kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme, që i kontribuojnë drejtpërdrejt zbatimit të kurrikulës.

# Grupi punues i angazhuar në hartimin e Kurrikulës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme

1. Labëri Luzha – udhëheqëse e divizionit për edukimin në fëmijërinë e hershme MASHTI – kryesuese
2. Feime Llapashtica – Lipscomb – udhëheqëse e divizionit për planprograme dhe tekste shkollore – MASHTI – zëvendëskryesuese
3. Imrane Ramadani – zyrtare për nivelin 0-6 – MASHTI – anëtare
4. Shqipe Gashi - zyrtare e lartë për planprograme dhe tekste shkollore – MASHTI – anëtare
5. Arbër Salihu – zyrtar i lartë për planprograme dhe tekste shkollore – MASHTI – anëtar
6. Fehmi Krasniqi – zyrtar i lartë për planprograme dhe tekste shkollore – MASHTI – anëtar
7. Besjanë Krasniqi – zyrtare e lartë për planprograme dhe tekste shkollore – MASHTI – anëtare
8. Fatos Osmani – këshilltar i ministres për arsimin parauniversitar – MASHTI – anëtar
9. Serdan Kervan – As. profesoreshë – universiteti Ukshin Hoti - Prizren – anëtare
10. Blerta Perolli Shehu – prodekane – fakulteti i Edukimit Prishtinë – anëtare
11. Rozafa Ferizi-Shala – udhëheqëse për programin parashkollor – fakulteti Edukimit – Prishtinë – anëtare
12. Linda Hoxha – As. profesoreshë – Universiteti i Prishtinës – anëtare
13. Zehrije Plakolli – hulumtuese në Institutin Pedagogjik të Kosovës – anëtare
14. Lumnije Çitaku – drejtore e institucionit parashkollor “Ardhmënia” – Prishtinë – anëtare
15. Indira Huruglica - drejtore e institucionit parashkollor “Gëzimi Ynë” – Prishtinë – anëtare
16. Selvigone Jasiqi – përfaqësuese e institucioneve parashkollore private – anëtare
17. Valona Gashi – edukatore në shkollën fillore “Hasan Prishtina” - Prishtinë – anëtare
18. Dafina Krasniqi – zyrtare për zhvillim në fëmijërinë e hershme – UNICEF – anëtare
19. Remzije Krasniqi – përfaqësuese nga KOMF – anëtare
20. Lulavera Behluli – koordinatore e programit të edukimit – Save the Children – anëtare
21. Shukrije Lecaj – kordinatore pedagogjike – CARITAS – anëtare



